

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 248, Qershor 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë: Papa Françesku miraton shpalljen e dy të lumnuemëve të tjerë shqiptarë 2

Dom Gjon Gazulli dhe Atë Luigj Paliq në altarin e shenjtërisë. Lajm i gëzueshëm për Popullin shqiptar dhe për Kishën katolike në vendin tonë. Atë Luigj Paliq dhe Dom Gjon Gazulli do të shpallen të lumë dhe kështu do t'i bashkohen 38 martirëve të tjerë, të cilët u shpallën të tillë në vitin 2016. Nëpërmjet një komunikate, Selia e Shenjtë, sot, më datën 20 qershor 2024, shpalli dekretin e Dikasterit për Çështjet e shenjtërve, nëpërmjet të cilit Ati i Shenjtë dekreton dhe autorizon Lumnimin e Dom Gjon Gazullit dhe Atë Luigj Paliq.

Dom Gjon Gazulli i ekzekutuar nga Mbreti Zog në Shkodër në vitin 1927. Ndërsa Atë Paliq i vrarë për urrejtje ndaj fesë nga regjimi Serb-Jugosllav, në Kosovë në vitin 1913. Këta meshtarë dhe jeta e tyre, janë tregues së përpjekjes dhe përkushtimit tërësor që Kisha katolike në vendin tonë pati për Fe e Atdhe.



Promovimi i librit "Flas me shpirtin tim" 3

Më datë 10 qershor 2024, në mjediset e Bibliotekës "Marin Barleti", Shkodër, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në bashkëpunim me Drejtorinë e Bibliotekës "Marin Barleti", Shkodër, organizuan promovimin e librit me titull "Flas me shpirtin tim", në të cilin morën pjesë të afërm, nënkryetare e Bashkisë Shkodër, zj Teuta Shala-Qyteza, intelektualë, profesionistë të fushave të ndryshme e të tjerë të interesuar ndër ta edhe të rinj e të reja me aftësi ndryshe të Shoqatës "Projekti Shpresa".

E kush mund ta shkruajë një libër të tillë dhe si mund ta bëjë këtë? Normalisht që një poet, një autor, i cili ka një frymëzim, që i rrjedh nga pjesët më të thella shpirtërore mundet.

Kush është ky autor? Ai quhet Tonin Arrinaj, i cili ka lindur në Theth, më 13.10.1960. Ka kryer shkollën e mesme për teknik pyjesh. Disa vite ka punuar në ndërmarrjen e hekurudhave. Prej tridhjetë vitesh jeton e punon në Itali. Aktualisht punon si zograf në Milano. Është i apasionuar pas historisë, pikturës dhe letërsisë. Flas me shpirtin tim (rapsodi për vendlindjen) është libri i parë për autorin.

Çfarë përmban ky libër? Cila është stilistika dhe metrika, që ka përdorur autori? Cilat janë mesazhet? E të tjera si këto, të gjithë pjesëmarrësit e ftuar patën kënaqësinë për ti dëgjuar drejtpërsëdrejti.



SHKODRA DHE MALËSIA E PRESIN ME RESPEKT DHE E PËRCJELLIN ME MIRËN JOHJE Z. NDUE FTONI 7

Pas rreth pese viteve Ndue Ftoni vjen në Shkodër, me datën 13 maj 2024 dhe largohet pe në Miçigan, me 20 qershor 2024, mbi një muaj në qarkun e Shkodrës, në Shkodrën e zemrës së tij e të familjes. me u kënaq me familjaret e tij, me miq e shokë, me vendin, që malli ishte i pafund ... Ketë mall e dashuri për miqtë e shokët e bëri realitet me një here, duke i bashkuar në qendrën kulturore "Në Art Center Blu-Skay", mbi 100 vete deri personalitete të artit e kulturës, këngëtar, valltar, instrumentist, humorist, veprimtar të fushave të ndryshme e të tjerë e të tjerë, dhe në mes tyre: Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, z. Gjergj Leqezja, ...

NJË TJETËR FESTË IU SHTUA KALENDARIT KULTUROR NË MALËSI TË MADHE ... 10

Agroturizmi "Buni & Kulla e Bajraktarit me mbështetje të Ministrisë së Turizmit dhe Miedisit, në bashkëpunim me fermerët, dhe blegtorët e zonave alpine, shoqatat kulturore dhe artistët e artit burimor rrëzë Alpeve Shqiptare e jo vetëm, në kuadër të nismës "Trans'humanca Identitet Kulturor Kombëtar" e mbrojtur nga UNESCO organizuan manifestimin kulturor 2 ditor "FESTA E ÇOBANIT MES MALËSORËVE TË BOGËS". I gjithë organizimi festiv ishte i lidhur ngushte me Xhubletën në prehrin e së cilës u rriten dhe trashëguan në shekuj këta çoban (barinj) rrëzë Alpeve Shqiptare. U rriten dhe fisëruan, u burruan dhe plakën krah xhubletës malësore, ...

Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë

Papa Françesku miraton shpalljen e dy të lumnuemëve të tjerë shqiptarë

Dom Gjon Gazulli dhe Atë Luigj Paliq në altar të shenjtërisë.

Lajm i gëzueshëm për Popullin shqiptar dhe për Kishën katolike në vendin tonë. Atë Luigj Paliq dhe Dom Gjon Gazulli do të shpallen të lumë dhe kështu do t'i bashkohen 38 martirëve të tjerë, të cilët u shpallën të tillë në vitin 2016.

Nëpërmjet një komunikate, Selia e Shenjtë, sot, më datën 20 qershor 2024, shpalli dekretin e Dikasterit për Çështjet e shenjtërve, nëpërmjet të cilit Ati i Shenjtë dekretin dhe autorizon Lumnimin e Dom Gjon Gazullit dhe Atë Luigj Paliq.

Dom Gjon Gazulli i ekzekutuar nga Mbreti Zog në Shkodër në vitin 1927. Ndërsa Atë Paliq i vrarë për urrejtje ndaj fesë nga regjimi Serb-Jugosllav, në Kosovë në vitin 1913. Këta meshtarë dhe jeta e tyre, janë tregues së përpjekjes dhe përkushtimit tërësor që Kisha katolike në vendin tonë pati për Fe e Atdhe.

Dom Gjon Gazulli

Lindi në Dajç të Zadrimës (Lezhë), më 26 mars 1893. Pas shkollës fillore në vendin e tij, filloi studimet në Seminarin Papnor të Shkodrës. Në vitin 1912 vazhdoi studimet në Romë, më vonë në Francë, e pastaj edhe në Austri, por jo gjithmonë vetëm për arsye studimi, por edhe për arsye shëndeti. U shugurua meshtar më 4 gusht 1919. Qe një kundërshtar i vendosur i qeverisë së mbretit Zog, që diskriminonte zonat e Dukagjinit, të Pukës dhe të Mirditës, zona tërësisht katolike. Insistimi i tij për të dënuar një regjim të tillë pati pasoja: më 26 dhjetor 1926 u arrestua. Mjaft shpejt, saktësisht më 2 janar




1927, u dënua me vdekje dhe u var. Fjalët e tij të fundit, të përcjella nga një dëshmitar okular qenë: "Po vdes i pafajshëm. Rroftë Krishti, Mbreti ynë! Rroftë Kisha Katolike, Nëna jonë! Rroftë Papa, Ati ynë!

Rroftë Shqipëria dhe shqiptarët e vërtetë!". Kjo ndodhi më 5 mars 1927. Kjo dëshmi u tregua nga një oficer i pranishëm në momentin e vdekjes së tij.



Dom Gjon Gazulli



Atë Luigj Paliq (Palaj)

Atë Luigj Paliq (Palaj)

Atë Luigj Paliq (Palaj) lindi më 21 shkurt 1879 në Janjevë afër Prishtinës (Kosovë), në dioqezën Shkup-Prizren. Pas shkollës fillore në vendlindje, u transferua në Shqipëri ku hyri në familjen rregulltare të Françeskanëve, në Kuvendin e Troshanit (Lezhë). Këtu bëri formimin për rregulltar dhe noviciatin. Vazhdoi studimet filozofike në Itali gjatë viteve 1896 – 1901. Me kushtet e përjetshme të jetës rregulltare ndër françeskanë, sipas traditës rregulltare të kohës, ndërroi emrin e pagëzimit nga Mati në atë të jetës rregulltare, Luigj, i frymëzuar nga jeta e Shën Luigjit Gonzaga.

Atë Luigji Paliqi u shugurua meshtar më 21.09.1901. Pas shugurimit meshtarak u ndal në Romë edhe për dy vite të tjera për studimi pas-universitar. Misionin e tij meshtarak e rregulltar e filloi në Kosovë në famullinë e Pejës, të fshatit Gillogjan, e më vonë edhe në shenjtëroren e shëna Ndout në Gjakovë. Nga viti 1905-1907 qe famullitar në kryedioqezën e Shkodrës. Nga viti 1907-1912 qe emëruar rektor i shenjtërores së shëna Ndout të Gjakovës. U martirizua më 7 mars 1913, në fshatin Janosh afër Gjakovës, për faktin se nuk pranoi të bëhej prift ortodoks, ku përkohësisht edhe u varros. Trupi i tij më vonë u transferua në varrezat e Shën Gjergjit, në famullinë kishtarë të Zymit të Prizrenit. Ky françeskan i jashtëzakonshëm jetoi duke dëshmuar, jetuar e mbrojtur fenë në Zotin, idealet dhe të vërtetën për fe e atdhe.

REDAKSIA

Kristela Bytyçi, deputetja e parë shqiptare në parlamentin e Brukselit.

Në zgjedhjet e 9 qershor 2024, në Belgjikë, 22 shqiptarë të radhitur në formacione të partive të ndryshme politike hollën kandidaturat e tyre, për tu zgjedhur deputete, në parlamentin e Brukselit. Nder të gjithë këta kandidatë, fituese u zgjedh Kristela Bytyçi.

Kristela Bytyçi, e lindur më 1 mars 1988, vajzë me origjinë nga Tropoja, ishte vetëm 8 vjeçe, kur familja e saj (si shumë familje shqiptare në atë kohë) emigroi në Belgjikë, Bruksel, për një jete më të mirë. Është diplomuar për shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në ULB (Universiteti i Lire të Brukselit). Pasi përfundoi studimet, ka punuar për rreth 3 vite në selinë e partisë MR (Partia liberale e qendrës së djathtë), në Bruksel. Më pas u bë pjesë e institucioneve evropiane, në të cilat vijon të punojë edhe sot.

Pas zgjedhjeve të datës 9 qershor 2024, Kristela Bytyçi u zgjedh deputete e parlamentin të Brukselit.

Kristela, që kur ishte e vogël, u shfaq interesi i saj për politiken në përgjithësi, i cili lidhej edhe me temat, për të cilat diskutoheshin në përditshmëri, me familje. Kjo beri, që Kristela të ndërjegjësohej, për të gjitha mundësitë, që të jep Brukseli, kryeqyteti i Evropës, dhe kështu vendosi të angazhohej e të jetë aktive në politiken belge.

Sipas Kristeles, vlerat thelbësore të demokracisë janë liria e të shprehurit, të menduarit, mendimi kritik e të tjera. Ato ndihmojnë në emancipimin apo zhvillimin e shoqërisë, në të cilën jetojmë dhe janë po këto vlera që e kanë udhëzuar të angazhohej në politikë.

Ajo shprehet, për gazetën "Dukagji-

ni", se ka qenë gjithmonë e ndjeshme ndaj disa temave, si për shembull, për barazinë gjinore, shkollimin, ndihma ndaj rinisë, shanset e barabarta, emigracioni e të tjera, sepse ashtu siç thoshte Nene Tereza: "Ne vetë ndjejmë që ajo që bëjmë është thjesht një pikë uji në oqean, por oqeani do të ishte i mangët pa atë pikë uji", që të kujtojmë, se çdo gurë, sa do i vogël që të jetë, e ka rëndësinë e vet në ndërtimin e përbashkët të një shoqërie më të mirë.

Përgatiti
ZEF NIKA, Bruksel



Promovimi i librit “Flas me shpirtin tim”

Më datë 10 qershor 2024, në mjediset e Bibliotekës “Marin Barleti”, Shkodër, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bibliotekës “Marin Barleti”, Shkodër, organizuan promovimin e librit me titull “Flas me shpirtin tim”, në të cilin morën pjesë të afërm, nënkryetare e Bashkisë Shkodër, zj Teuta Shala-Qyteza, intelektualë, profesionistë të fushave të ndryshme e të tjerë të interesuar ndër ta edhe të rinj e të reja me aftësi ndryshe të Shoqatës “Projekti Shpresa”.

E kush mund ta shkruajë një libër të tillë dhe si mund ta bëjë këtë? Normalisht që një poet, një autor, i cili ka një frymëzim, që i rrjedh nga pjesët më të thella shpirtërore mundet.

Kush është ky autor? Ai quhet Tonin Arrinaj, i cili ka lindur në Theth, më 13.10.1960. Ka kryer shkollën e mesme për teknik pyjesh. Disa vite ka punuar në ndërmarrjen e hekurudhave. Prej tridhjetë vitesh jeton e punon në Itali. Aktualisht punon si zograf në Milano. Është i apasionuar pas historisë, pikturës dhe letërsisë. Flas me shpirtin tim (rapsodi për vendlindjen) është libri i parë për autorin.

Çfarë përmban ky libër? Cila është stilistika dhe metrika, që ka përdorur autori? Cilat janë mesazhet? E të tjera si këto, të gjithë pjesëmarrësit e ftuar patën kënaqësinë për ti dëgjuar drejtpërsëdrejti.

Përmbledhtazi autori vë në dukje se frymëzimi i ka ardhur thellë nga malli dhe dashuria lidhur me vendlindjen, ka filluar të shkruajë varg pas vargu, duke e lejuar veten të jetë i lire, por edhe duke përcaktuar strukturën dhe formën me rimë dhe respektuar tingullin, ritmin dhe muzikalitetin e strofave. Ka përdorur një gjuhë të kombinuar, diku letrare, diku vendase e diku atë shkodrane, veriore, ashtu sikur i ka ardhur muza në mënyrë të natyrshme. Është përpjekur të ngjallë tek lexuesi emocione reale jo thjesht të krijuara dhe që të nxitë rëndësinë e vendlindjes, për të cilën duhet të jemi përgjegjës në forma të ndryshme, në rastin e tij e ka thurur në vargje, duke iu drejtuar kujtdo lexuesi që mund të jetë i interesuar në një gjuhë të kuptueshme që lejon hapësirë për vlerësim dhe interpretim personal. Doli në pah nga diskutimi me autorin rëndësia e stilit origjinal në të shkruar pavarësisht se, ai ka lexuar një gamë të gjerë librash dhe autorësh të njohur në nivel kombëtar e ndërkombëtar, të cilët kanë ndikuar në formimin dhe intelektin e tij. Por ndër të tjera autori thekson se të gjithë kanë pasur qasjen dhe stilin e tyre të të shkruarit, pikërisht për këtë ai vlerëson të qënurit vetvetja, të pasurit e një stili unik, plotësisht të tijin. Kur ka pasur frymëzimin e të shkruarit, nuk e ka bashkëndarë me të tjerë, por e ka hedhur në letër, kryesisht duke e shkruar në mjedisë familjare. Në strofat e tija ka pasqyruar realitetin, sepse sipas tij realiteti është ai që është dhe nuk ka nevojë për shumicë, për ta pranuar atë që ekziston në të vërtetë. Çdo përvojë që nga fëmijëria, emigrimi, jeta e vështirë, përpjekjet për të punuar shumë, për të

krijuar një jetë më të mirë, ajo çfarë i ka munguar shqiptarëve në përgjithësi, të gjitha kanë formësuar eksperiencën e tij, të cilën e ka kthyer në vargje poetike, duke i dhënë vetëm nuanca krijuese reale. Autori është shprehur se do jenë lexuesit ata që do i japin vlerën dhe interpretimin përgjatë kohës se ku do e vendosin këtë libër të shkruar nga ai vetë dhe se çfarë vendi do të zërë do jetë vetëm koha që do e tregojë. Në mbyllje thekson një mesazh të fortë për të gjithë poetet e rinj, që në çdo moment të jenë origjinale, të përcjellin natyrshëm, të jenë vetvetja dhe të punojnë shumë me veten, duke u përpjekur që me krijimet e tyre të nxisin përmirësim të jetës në vendin e vet ku janë lindur e rritur duke pasur në fund një motiv për të qëndruar në vendlindje.

Pas pjesës së parë, në sfond u vendos pak muzikë instrumentale me tingujt e pianos...

Në pjesën e dytë u vijua me analizën e librit, të cilën e filloi z. Leonard Qyteza, inxhinier, i cili bashkëndau me pjesëmarrësit një analizë të detajuar, duke i dhënë vlera në nivel maksimal për stilin e të shkruarit, për përmbajtjen e tij si dhe rekomandoi, që të gjithë përfshirë edhe Bibliotekat, duhet të shtojnë librin e tij

Më pas z. Prelë Milani, publicisti, autori mirënjohur i shumë veprave letrare, theksoi me nota superlative punën krijuese të rrallë me 382 faqe të autorit Ndër të tjera vlerësoi shumë stilin origjinal ku njëra anë i qëndron besnik idesë së tij e nga ana tjetër sjell një bagazh me peshë në aspektin e stilistikës dhe metrikës letrare. Ishte një folme shpirti, që do mbetet në fondin e poemave tona. Respekti për punën pasionante të pa zhurshme, modestinë e komunikimit, gjuhën e figurshme dhe mesazhet e larmishme, që përcoll autori për mes veprës së tij të shkruar në mërgim me flakë dashurie e shqiptarie. Ky libër meritonte një prezantim të ngrohte profesional e me vlera si ky i sotmi. Urime më të mira mikut tonë të përkushtuar Tonin Arrinaj

Më pas, z. Mhill Shkambi krahas vlerave të radhitura nga parafolësit tërhoqi menjëherë vëmendjen se ndër pjesëmarrësit duhej të ishin edhe nga rrallët e figurave të shquara intelektuale në këtë fushë, që të kenë mundësinë për tu njohur e për të dëgjuar drejtpërsëdrejti nga vepra e këtij autori.

Në mbyllje të pjesës së dytë, po ashtu, zj. Suela Ndoja, psikologe klinike pranë Shoqatës “Projekti Shpresa” bashkëndau me pjesëmarrësit një analizë të mirëfilltë psikologjike të librit duke nënvizuar komponentë të rëndësishëm dhe mesazhin që përmban poema përveç elementëve artistikë.

Përmbyllja u bë nga z. Ndue



Sanaj, Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, i cili vuri në dukje rëndësinë e promovimit të këtij libri si dhe vlerat që përcjell në realizimin e misionit të kësaj shoqate. Ftoi z Gjergj Leqezja, që ti dorëzojë titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini” autorit Tonin Arrinaj, me motivacionin:

“Për kontributin e veçantë të dhanë nder vite në mbështetje të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”; për krijimtarinë e spikatur letrarë, një vlerë e çmuar e trashëgimisë tonë kulturore e artistike; për shembullin e mirë, që pasqyroni ju dhe familja juaj, me cilësitë më të mira

të dukagjinasit e qytetarit”

Nga ana e autorit pati një fjalim modest e mjaft miqësor, në të cilin ndër të tjera përcolli emocionet e të qënurit në sallë me të gjithë pjesëmarrësit, që e kishin nderuar me praninë e tyre së bashku me falënderime të veçanta.

Të gjithë pjesëmarrësit u ftuan në një koktejl, të ofruar nga vëllai i autorit. z. Viktor Arrinaj.

Përgatiti, SUELA NDOJA (anëtare e Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”)



OPINIONE - "Flas me shpirtin tim"

LEONARD QYTEZA

Sot, më 10 Qershor 2024, në këtë tempull të kulturës sonë të Shkodrës, në Bibliotekën "Marin Barleti", një ngjarje e bukur na ka mbledhur, promovimi i librit "Flas me shpirtin tim - Poemë" i autorit shkodran, Tonin Arrinaj.

E theksova datën e sotme, 10 Qershor, për rastësi me ngjarjet tona kombëtare dhe se bashkëndodhitë janë të bukura dhe ndihmojnë për t'u mbajtur mend.

10 Qershor 1878, burrat e dheut të Gjergj Kastriotit themeluan "Lidhjen Shqiptare të Prizrenit" dhe 10 Qershor 1924, 100 vite më parë nga sot, forcat demokratike fanoliste erdhën në pushtet.

Rastësia vijon edhe me datën e fillimit të hedhjes së fjalës së parë në fletoren laborator krijuar të autorit Tonin Arrinaj, që daton 10 gusht 2010.

Unë nuk jam ndonjë lexues i xenshëm i letërsisë e aq ma pak një kritik letrar, jam thjesht një mik i librit. Librin në fjalë e mora me dedikim nga Vitori, vëllai i autorit. Që në nisje më befasoi, sapo hapa faqen numër 3, aty ku fillon strofa e parë. Diçka jo e zakonit, ndesha në një libër pa një hyrje si parathënie, pa një dedikim apo dhe ndonjë varg nga psalmet. E kështu u shtyra t'i hedh një shikim të shpejtë formatimit të librit, faqe pas faqesh, askund një kapitull, askund një ndalim, por vetëm vargje poetike që rrjedhin, duke gurgulluar e shkumëzuar si ujët e kristalta të Lumit të Shalës.

Një libër voluminoz me 382 faqe, që rrëshqasin me frymëzim dhe përkujdesje në stilin poetik me plot 2660 strofa, një rast unik në letërsi, aq nuk ka as "Komedia Hyjnore" apo edhe "Lahuta e Malësisë", e cila ka vetëm 30 Këngë me tematikë kushtuese.

Në libër, të shpërndara janë edhe 6 fotografi të cilat, me qëllim, autori i ka vënë në libër si simbolika, që tregojnë në një farë mënyre kapitujt e librit.

Dy fotot e para nga Thethi, simbolet e majave, kurdoherë imazhet e tyre të njohura në Guidat turistike e frymëzojnë edhe autorin ta vargëzohet vendlindjen e tij, Thethin, me gjithë bukuritë e tij mahnitëse: "Der' tek Syri i Kaltër sipër përmbi Gerla, / Rrjedhin ujë të ftohtë kroje e burime, Thethë ti je i pasur, ke një varg me perla, / Ti ma bën të pasur dhe ktë qënien time." Në foton që pason, që për mua vijon një kapitull tjetër poetik e përjetimesh jetësore të autorit, që fillon me emigracionin e tij 30 vjeçar, është anija "Vlora" mbushur me refugjatë të ngratë shqiptarë që tronditi të gjitha kanalet televizive të botës në gushtin e vitit 1991. Askund më parë nuk ishin parë imazhe të tilla, të cilat edhe sot të rrëqethin mishin, kur i sheh, jo ma, kur dikush i kujton në vetën e parë, si autori i librit, Tonini. Emigracioni shqiptar ishte drama më e madhe që përjetoi populli shqiptar pas periudhës së gjatë të izolimit dhe problemeve të shumta me sistemin politik dhe ekonomik, që shoqëroi jetën tonë për gadi 4 dekada. Kushtet ekonomike dhe mungesa e lirisë

i detyruan shqiptarët të kërkojnë një jetë tjetër, që thellë në ndërvetëdijet e tyre krijonte iluzione që kur i prekje, nuk ishin të tilla dhe ndaj në vargje Tonini fshante: "E s'ka pasur një natë qoftë, një natë të vetme, / Që jastëku im të rrinte i thatë." E vazhdon me zemren plot pikëllim: "Mundohesha të flija me një sforco sublime, / Trenat vërshejllenin mbi urën përbri, / Harroja hallet e veten time, / Plot mall kujtoja dy fëmijët e mi."

E si ndodh me të gjithë njerëzit vullnetmirë të botës, në hall e në ligësi, Zotit e nënës i përgjeronen: "E të kam thirrë o nënë, halli kur më zinte, / Dhe kur flija jashtë me zemrën bërë pleh, / "Fli o biri im!", zëri yt më vinte, / Shyqyr nëna ime sonte nuk më sheh."

Por emigracioni shqiptar nuk ishte vetëm i ngjyrosur në zi, e zeza në natyrë nuk ekziston, as në shpirt, madje, as në vaje, te malësori jo e jo. Emigrimi erdh' për mua si rrëqethje në zemër, thotë Tonini. Ngadalë - ngadalë, me punë dhe besim, me sakrificë dhe ndershmëri, shqiptarët në përgjithësi dhe autori ynë, në veçanti, u integruan në jetën e vendit ku qëndruan dhe për ta, filloi një kapitull i ri, që në faqet e librit jepen me dy foto të bukura nga Milano, me "Duomoni, Katedralja Metropolitane e Lindjes së Virgjëreshës së Bekuar dhe monumenti i "Leonardo da Vinci" në kujtim të tij në "Piazza della Scala" të Milanos. Në rrugët e Milanos tretësia në mendime, citon diku autori, te ai qytet metropolitane, i artit, i modës së lartë, i industrisë dhe sportit, aty ku ai zuri vend dhe jeton familjarisht, duke punuar edhe si artist në një profesion të bukur. Tek ecën nëpër atë qytet plot zhurmë, monumente dhe vepra arti, të gjithë mjeshtrit e mëdhenj të mesjetës i shikon dhe i përjeton si frymëzim, Leonardo, Mikelanxhelo, Karavaxhio që kanë ngehur thellë në shpirtin e tij, nga leximet e dikurshme në rininë e tij, por edhe nga çka takoi në jetë në Romë, Firence e tash në Milano. "Vrapon Milano ditë e natë zgjuar, / Milano e ndërtoar gjithnji me art," e në një strofë, në ekzaltim, i drejtohet Da Vinçit: "O i madhi Mjeshtër, për ty thur lode, / Ti ecën me kohrat që kurr' s'të ndalojnë, / Me mbi gjashtëmijë skicime e kode, / E mundohen, por pak munden të deshifrojnë."

E kështu nuk rreshtin vargjet për bukuritë e qyteteve italiane, atyre që i viziton dhe aty ku punon. Sado Italia është e bukura e "dheut", përsëri mërgimtari, tek atdheu ka shpirt e rrënjë.

"O atdhe, Atdheu im, / Në zemrën time je si moti, / Her' ke diell, her' gjënim, / Sa të dua e di veç Zoti." Në vijim, pjesa më e madhe e librit i kushtohet Dukagjinit, heronjve të tij, vlerave patriotike, trimave dhe luftëtarëve. Kur autori shkruan për Theth e Dukagjin, ndryshe nga vargjet e tjera, ai merr "lahutën" e tij të penës e shkruan për Lekët e veriut. Kapitujt e këtyre epopeve jepen në libër me fotot e kryetrimave,

të Lek Dukagjinit, të Avdi Kolës, të Mehmet Shpendit dhe të Mark Lulës. Gama e personazheve, ngjarjet e fenomenet historike, vendet e bukura ngado ku shkel e kalon, përjetimet personale të hedhura në vargje, të bëjnë të mendosh se autori Tonin Arrinaj, gjatë jetës së tij të hershme e deri sot, duhet të ketë lexuar aq shumë libra, aq shumë letërsi sa, biblioteka e tij personale në shtëpi, të ketë hapësira më shumë se të gjitha ambientet e tij jetësore. Eh, Dukagjini im! - fillon një faqe libri e vargjet i rrëshqasin vullshëm, çfarë nuk radhitë për të, natyrë e historit, plagë të dikurshme, ujë e bukuri, krenari të burrit e hijeshi të gruas, Dukagjin do të thotë jehonë, Dukagjini është dhimbje. Dhimbje e nanës, dhimbje! "Dukagjini im! / Oh, shkëmb i varrit tim! / Duka do të thotë shkëmb e gjini, nanë".

Duke lexuar vargjet e këtyre kapitujve, të duket sikur e fton P. Gjergj Fishta të këndojë dhe Tonini "Lahuten e Malësisë" si edhe poeti ynë kombëtar të tijen. Natyrisht, Fishta e shkruan veprën e tij përgjatë 30 viteve e në disa pjesë, ndërsa Arrinaj duhet të punojë përditë, të jetojë përditë, të kujdeset për familjen e tij përditë. Në shpirtin e poetit përthihen si në një pasqyrë konkave, të gjitha përjetimet e tij të hedhura, duket çdo ditë në një bllok - laborator krijimi, palosen varg pas vargu ndjesitë e tij poetike që përjeton, imagjinatën që e trandë:

"Po pate në DNA imagjinatën e shkretë, / Gjith' jeta të bëhet shkollë për të mësuar, Duhet thënë, që shkolla duhet vërtetë, / Por jo të jetë, veç armë për të uzurpuar."

Dhe Tonin Arrinaj ka kryer shkollën e mesme për teknik pyjesh, por punon si zograf dhe i apasionuar pas historisë, pikturës dhe letërsisë dhe diçka i kujtohet për të shprehur mendimin se, të shkruash një libër të tillë me kaq shumë strofa të lidhura në sistemin katërvargësh me tingëllim poetik, nuk mjafton të jesh shkrimtar universitar, por i racës së dukagjinastit ngadhënjimtar: "Më kujtohet një frazë e Bill Geitskurthoshte, Kam mbetur në shkollë në disa provime, E një shok i klasës që gjithmonë i kalonte, / Është inxhinier në vartësinë time."

Dhe kthehet Tonini nga vetja e tij: "Kemi lindur për diçka e jo ashtu kot së koti, / Satalentekane humburnëm muratorë oçoban, Talenti është një dhuratë nga Zoti, / Por suksesi është mundimi që ti mban."

E për të përfunduar po citoj diçka të Toninit për Shkodrën: "Ka Bota qytete që vërtetë praruar, / Por kudo të shkosh Shkodra të thërret, Ajo t'i fut ethe e shpirtit të dashuruar, / E në zemër s'të mbetët një tjetër qytet."

Dhe në fund të librit autori bën një premtim dhe një deklaram: "Do shkruaj veç ato që më ka mësuar jeta, / Ato që kam vuajtur e kam dëgjuar, Në librin tim do jetë e vërteta, / Kohës do ja lë për të treguar."

E tani, mendimi im: Melibrine Tonin Arrinajt "Flas me shpirtin tim - Poemë" kemi të bëjmë me një autor

si pak të tjerë, me një libër artistik të rrallë për nga volumi, për nga pathosi i shkrim-it, për nga bukuria e vargut dhe thellësia e mendimit, autentik dhe gramatiki shkurt, me gjuhë lakonike të përzier në gegnisht por edhe në letraren e gjithpranuar. Është detyrë e Shoqatës së Shkrimtarëve të Shkodrës, e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që të gjejnë format dhe mënyrat që ky libër të njihet në shkolla, në rrethe letrare, të dhurohet nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini" mundësuar nga mbështetësit e saj nëpër botë dhe në trevat shqiptare, që s'i ka të paktë e as "të lodhur", në mënyrë që libri të bëhet pjesë e bibliotekave personale, në Bujtinat e Thethit të jetë libër për shitje, por edhe në bibliotekat e Shkodrës, "Marin Barleti" dhe "Zoja e Shkodrës", të zënë vend në fondet e tyre.

FLAS ME SHPIRTIN NJË LUMË QË BURON PREJ SHPIRTIT

PRELE MILANI

Me datën 10. qershor 2024, në sallën e veprimtarive kulturore të Bibliotekës "Marin Barleti", në Shkodër në mesin e krijueseve, poetëve, miqve, intelektualëve dhe dashamirëve të afirmuar të librit u bë promovimi i poemës "Flas me shpirtin" i autorit Tonin Arrinaj. Kjo poeme e gjerë sa shpirti i pa anë i autorit dhe e gjatë sa hapësira shqiptare ngjanë si një ahishte plot lisa e pipa, me dushk e me bare, burime e kroje. Poetika e këtij vëllimi i përngjanë horsteve të thikta që puthen me qiellin dhe grabenve zbritëse drejt mantelit të tokës.

Tonin Arrinaj vjen pa zhurmë, pa bujë, pasi ka shtegtuar viseve të largëta, në të cilat e dërguan zbatikat dhe baticat e jetës. Ujëvara e tij gurgullues përthyer në jone poetike e merr hapësirat, fluturake mes dhimbjesh e ëndrrash shpresë mira.

Autori vjen i mbushur me pjalmi poetike të mbledhur lule më lule të bekuar nga muzat hirplotë e gjë bekuara. Tonin Arrinaj e ka ndërtoar bujtinën poetike me varg të latuar hollë. Libri është mozaik harmonik ndjenjash të dëlira dhe marshesh fluturake rebele pa gjetje të sforcuara. Tonini ecën i menduar e vjen si vetja i lare në një shi të ngrohte metaforash. Meditimi i tij poetik buron prej labirinteve të një shpirti delikate të vuajtur, shpesh here të përçmuar padrejtësisht vetëm nga qenia me pak si dukagjinast e më shumë si shqiptarë. Kundër këtij fenomeni përçudnues autori ngre kordhën e Pirros, e mburojën Kastrioti, ligjësinë dhe humanizmin e Lekes, virtytin bujarinë, humanizmin shqiptarë. "Kur Leka i madh mësynte me ushtarët / O eterin në shqip kështu i kanë thirre / E Pirro Krenarë Veshton kundërshtarët / Romak të ri më qytetërim të mire"

I pajisur me ketë tepçicë të tharë me të racës se vjetër poeti, behet më shumë dukagjinast dhe shqiptarë i thukte ndaj ati kori më të madh frymësh, që i kanë bjerrë ato virtyte të thukte që poeti dhe kombi i tij amë i kanë në gjak shpirt dhe identitet.

◀ Vargu i Tonin Arrinajt ka mendim, përjetim, syzim, kohezion dhe përthyerje larg skemave të metrikes klasike. Libri fillon pa as një emërtese poezie, pa kapituj as nen kapituj poetik. Lënda e tij poetike buron nga shpirti i tij, duke merre me vete si ujëmbledhës gjithë burimet e vendlindjes dhe duke i bashkëngjitet detit të tij poetik here të qete e here të vallëzuar, herë trishtues gjer në dhimbje dhe herë të gëzuar e të qeshur si pranvera.

“Poshtë buron ky lumë i vogël / Gjarpëron luginën mbare, / Vezullon në dritë të hanës, / Here argjend here qelibare”

Libri ka brenda plot shigjetime idhnake kundër ligësive e veseve të shoqërisë së sotme apo ikjes pa kthim të pjesës më vitale të kombit. Nëse një poet zgjedhë heshtjen ose në qoftë se, i shërben pushtetit, mund të ketë nderime e benefice politike, por as gjë nuk e shpëton nga venitja vetëvrasëse poetike. Tonini ka zgjedhë kushtrimin në vend të heshtjes, sinqeritetin në vend të hipokrizisë, zgjuarsinë në vend të foddullekut, ndaj është rrokur gryka, gryka me virtytin e të mirën, duke shkëlluar me neveri vesin, të ligën dhe të shëmtuarën:

“Larg nga ti, qava lotova / Midis yjesh të kërkova / Zemra thirri kur mendova / Rrofsh moj Shqipëria ime”

Lexuesi vërtetë ndien një lloji trishtimi njerëzor, por autori na ka lenë edhe disa shtigje të lira ku e qeshura, romanecat lirike nuk e lënë lexuesin të dëshpërohet, madje e nxjerrin nga pesimizmi. *“Dheu i huaj ndoshta do më tresë / Por zemra ime nuk do mbesë / dashuria për ty kurrë nuk do vdesë / E merr me vete ëndrra e shpresë.”*

Poetika “Flas me shpirtin tim” afirmon dhe shpalose kredon artistike domethënëse të autorit si poeti i pjekur dhe krejtësisht origjinal, i mërguar fizikisht, i mire integruar në jetën e Milanos dhe shpirtërisht i lidhur me një mijë fije me Shqipërinë, që i fali jetën dhe bën krenarë si djalë i saj.

MHILL SHKAMI

Një poemë që shpreh së pari vlerat njerëzore e familjare të autorit dhe aftësisë së tij në krijimtarinë poetike, të cilat nënkuptohen nga vetë “Titulli i Librit”, “Flas me shpirtin tim”

Do të veçoja në komentimin tim se, çdo njeri që ka njohur nga afër autorin dhe familjen e tij, sidomos babën, të ndjerin Kole Noshi (Arrinaj) nuk do të habitet shumë për vlerat dhe dashurinë që autori reflekton në këtë poemë. Ky libër pasqyron vlerat më të mira të krahinës së Dukagjinit si besnikëria, trimëria, dashuria për vendin, mikpritja, si dhe bukuritë natyrore.

Nga ana tjetër, në libër tregohet edhe për vuajtjet e mëdha të këtij populli në historinë e vjetër e të re. Tekylibregjenvetençdonjeri, qënjemirë traditat dhe virtytet e trevës së Dukagjinit. Stili i të shkruarit, me një strofë të rregullt e me rimë sistematike, jo të sforcuar, flet nga ana tjetër për një dhunti të radhë.

Kjo poemë mund të thuhet se është një histori e shkruar me vargje për trevën e Dukagjinit. Parafolësit folën për librin në mënyrë shumë të bukur dhe analitike, ndaj unë nuk po zgjatëm, por dua të

ndalem tek një ndjenjë e brengë, që autori shpreh për vuajtjet e mëdha, sakrificat dhe mosmirënjohjen, që i është be popullit të Dukagjinit, ndonëse me një kontribut të madh e të veçantë në historinë kombëtare.

- Ja si shprehet autori për Dukagjinin:

Ah Dukagjini im, sikur duart e mia, / Sikur duart e mia të mund të shfle-tonin, / Faqe për faqe historinë, / Atë histori të pa memorie, / Do të doja të jetoja një ëndërr të çmendur, / Ku e përflakur do të më hynte në sy,

Të më hynte në zemër, / Historia jote, o bujari im, / O trimi im i çmendur! / E të flas me ty në mendimet e mia, / Dhe fjalët e mia jua gjuaj shkëmbinjve, / - Kur e morët kalanë e Rozafës, / Shumë qeshën e thanë;

“Dukagjinasi tjanëtëmarrë!” / “Janëtëçmendur!” / Si mund të vriten tetëmbëdhjetë veta, Për do mure të rrëzuara?! / - Kur ju dolët zot malësorëve të Dede Gjon Lulit, / Thanë këta janë të marrë, “Të çmendur!”

Ç’ju duhet atyre të vdesin për një krahinë tjetër, / Për një krahinë që s’i del kush zot?! / - Kur sulmuat Turkut Pashën, / Thanë: Dukagjinasi janë vërtetë, / Të çmendur,

A luftohet me topa dardhe e duke rrëzuar shkëmbinj?! / - Kur i dolët zot Mic Sokolit e Krasniqes, - Kur luftuat me Emin Bogiçin, / Ata thanë: Këta janë vërtetë të çmendur, Ç’ju duhet atyre, mund ti linin të kalonin, / Shkuan damë të gjithë ato djem?!

-KurindaluatserbëttekuraeShalës, / Të tjerë thanë: Dukagjinasi tjanëtëluajtur mëndësh, Të çmendur, / S’kanë bukë të hanë, / E duan të përulin kraljat.

- E kështu për luftën e Nikçit, / - E kështu për Gurin e Kuq / Për qafën e Boshit Për qafën e Tëthermës / Për Plavë e Guci / Për Tuz

- Leni thane të vriten, janë të çmendur, / - Kur sulmuat Zogun dhe hytë në Tiranë, / Thanë prapë: Këta janë të çmendur, / Zogu ka serbinë e ka me i qitë faret, / - Ju ishit krahina e fundit në Shqipëri,

Që ratë nën komunizmin ballkanik, / E quajtën çmenduri, / Eh Dukagjini im! / Jam krenar me çmendurinë tënde, / Jam i nderuar nga çmenduria jote, / Të dua o i çmenduri im! / Me afshin e shpirtit!

Sa shumë flasin këto rreshta, natyrisht për ata që e njohin historinë, vuajtjet e trimërinë e Dukagjinit e nëpërkamjen që historia i ka ba këtij popull me kontribut të pasqor për kombin.

- Nëse autori më “lejon” që këtij kalavar vuajtjesh e sakrificash do ti shtojsha edhe disa rreshta si:

- Kur Dukagjinasi u ulën për një jetë, më të lehtë në Shkodër e periferi, shumë thanë: Na mbytën, na njollësën, e tjetër e tjerë epitete përçmuese.... Po sot ku janë ?! Pa diskutim pjesa më vitale dhe aktive e Shkodrës e jo vetëm, kanë “parakaluar” në çdo fushë.

- Mbas viteve 90’ disa shkolla të qytetit filluan të përbusen me pretekstin se janë mbushë më fëmijë Du-

kagjinasi... po sot?! Pa diskutim, që nxënësit e studentët Dukagjinasi janë krenaria e arsimit në Shkodër.

- Kur filluan bizneset, shumë thanë me përçmim, edhe këta,

- Kur familja “Fusha” filloi të ndërtojë “Colosseon”, pati shumë që thane, po na njollësin qendrën... po sot....?! Familja Fusha, me hotelet e bizneset e saj janë krenaria e Shkodrës.

- Kur vëllai yt Tonin, “Viktori” filloi të tregonte pllaka e h/sanitare, thoshin edhe ky po sot?! Asht absolutisht kompania më e suksesshme në fushën e saj në të të gjithë veriun e vendit dhe jo vetëm.

- Kur poetë e shkrimtarë Dukagjinasi filluan të shkruanin e botonin, të tjerët thanë me përçmim “edhe shkrimtarë këta, po sot?!” - Pa diskutim, që janë elita e krijuesve në Shkodër dhe sot promovohet libri 78 nga autor dukagjinasi

- Kur Z. Ndue Sanaj, themeloi, me shoke e shoqe dukagjinasi, Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, të tjerë thanë nën zë, edhe ky - Po sot?! Kjo është shoqata më e organizuar dhe me më shumë kontribute kombëtare në të gjitha trojet Shqiptare.

- Falë tij dhe krijuesve Dukagjinasi, me në krye Prel Milanin, Luigj Shytin, Sulea Ndojen, Klodiana Serren e tjerë gazetarë Dukagjinasi del rregullisht gazeta Dukagjini, e vetmja periodike në Shkodrën e shkruar. Falë Kryesisë së shoqatës, zona e Dukagjinit, sot është “Nderi i Kombit”.

- Duke e mbyllur, me një falënderim e mirënjohje të veçantë për autorin, Tonin Arrinaj, dua t’u garantoj se autori nuk do ta mbyll këtu “Bisedën me shpirtin e tij”.

ANALIZË PSIKOLOGJIKE E LIBRIT “FLAS ME SHPIRTIN TIM”

SUELA NDOJA

* Në këtë poemë si uni ashtu edhe shpirti flasin për të shprehur karakteristikat e tyre. Në dukje të parë përveç qasjes artistike, të krijon përshtypjen se ka një qasje të filozofisë platonike pasi ekzistojnë tre parime në këtë botë, të cilat janë Uni (një transhëndencë supreme, e plotë Metafizike), Intelekti (Nous, aftësia e mendjes njerëzore për arsye të kuptuarit) dhe Shpirti (psikika). Në analizën time, dëshiroj të ndalem pikërisht tek parimi i tretë, që lidhet me titullin e këtij libri, i cili do të shpjegohet sipas perspektivave në vijim:

Në perspektivën e parë psikologjike flet shpirti i autorit; ku del në dukje se është ai që e udhëheq mendimin, për të kryer të gjitha veprimet. Fillimisht, thotë se “Unë thërras”, me këtë e bën trupin të shkojë drejt shkallës së lashtë zigzage, shkalla këtu përfaqëson jetën tonë dhe është e lashtë (e vjetër) pasi mund të thyhet këtu ose atje ose kudo që jemi (jeta është plot pezull). Merr rrezikun për të shkruar përpara larg vendlindjes, në emigrim, duke dëgjuar zërat e brendshëm të shpirtit, për të ecur në jetë. Një shpirt ka aftësinë të bashkojë të gjitha mendimet tona rrëshqitëse (kërkimi për arsye) në një zonë të vetme. Në këtë pjesë shpirti pyet veten: A mund ta ndajë dikush çdo aspekt tashmë të jetuar nga shpirti?

Në këndvështrimin e dytë psikofizik flet vetvetja, që është trupi. Këtu poeti ka përdorur nga përvojat e tij jetësore, për

të shprehur idenë aktuale të vetvetes, në jetën tonë. Ai është kushtëzuar të lëvizë nga vendlindja e tij, i ndikuar nga familja, përtej vendit tone, por që e përndjek kudo e në çdo moment malli dhe nostalgjia. Dhurata shpirtërore, që mbart me vete kudo që trupi i lëviz është vendlindja, që në fakt është trashëgimia kulturore e secilit, që dëshiron ta lejojë të jetë e të duket jo vetëm në sipërfaqe, por edhe në thellësi. Tehu i nostalgjisë, duket si një gotë, duket i mprehtë dhe ka të përfshirë mosha dhe etapa të ndryshme. Poeti thotë se, mbi gjunjët e tij shtrihet ‘vetja’, i cili ishte i mbështjellë nga një pëlhurë bashkohore. Ai do të thotë se, shpirti është një; ai mbetet i njëjtë; mjeti që përdor për të qenë në veprim mund të ndryshojë nga një moment në tjetrin, i cili është trupi; që mund të jetë i ndryshëm, por shpirti do të mbetet i njëjtë dhe nga vargjet e tija del në dukje se askush nuk e ka në dorë shpirtin, sepse ai triumfon mbi çdo pengesë e mbi çdo vështirësi.

Në këndvështrimin e tretë psikospiritual është vazhdim i këndvështrimit të parë. Shpirti këtu flet për intelektin e mendjes njerëzore, i cili endet në kërkim të arsyeve, për lindjen, jetën dhe zhvillimin e gjithanshëm përfshirë ndikimet ndërbreznore. Shpirti pyet: “Pse mendja njerëzore nuk është e kufizuar në emocionet e saj të jashtëzakonshme si dashuria dhe interesi i sinqertë për njëri-tjetrin, për të parët tanë, për historinë, për shoqërinë dhe për realitetin?” Pse po ecën këtu e atje (vetja e brendshme) për të marrë përgjigje? Shpirti përpigjet t’i bashkojë të gjitha këto mendime në strofat e krijuara, të cilat janë reflektuar në mënyrë të integruar dhe harmonike si vijueshmëri e njëra-tjetrës, duke i pasqyruar në formë të lire, por edhe duke shfaqur rimën ABAB

Në këndvështrimin e katërt psiko zhvillimor, është lidhja e strofave me një vete, që flet për vazhdimësinë dhe përsëritjen e veprimeve të shpirtit, përmes mjeteve të ndryshme historike, ndërbreznore, emigracioni, e të tjera. Këtu, shpirti thotë se “kur e bën njeriun të bashkojë të gjitha mendimet e tij rrëshqitëse dhe mendja e tij mbushet me një fuqi, ai shkon në një fazë ekstaze dhe gati nga njëra anë bëhet i shurdhër, i verbër dhe memec; dhe humbet intelektin e tij, sepse ai sheh një realitet, që është përtej mundësive të tij, por që përpigjet me të gjithë forcën e brendshme të mos dorëzohet, por të vijojë, duke I lejuar dhe duke I kërkuar vetes që të tregohet vetvetja. Cikli lindjetë-evolucion deri në vdekje bëhet një lak i pafund në të cilin shpirti është i njëjtë dhe vetvetja bëhet në forma të ndryshme, për të përsëritur jetën e vet pa pushim. Mundimi, përballja e dhimbjes dhe e vuajtjes dhe faza e përballimit; këto situata të pashmangshme përballohen nga vetvetja në forma të ndryshme, me forma të ndryshme përgjatë gjithë jetës janë një zinxhir i pathyeshëm. Siç e thekson edhe vetë autori:

E si është kjo jetë, kush vallë e merr vesh / Kjo jetë e shkretë, që ëndrrat ti jep / Në realitet të thotë kërkoi ti kthesh / Në fund realiteti është ai që vret

Jeta është si një trajektore, të gjithë njerëzit me të cilët autori është takuar, me të cilët ai është përballur, të gjitha situatat janë kryqëzuar, partnerët

◀ e jetës që ka zgjedhur, përvojat që kanë kaluar përsëriten në një formë tjetër. Kjo tingëllon dëshpëruese. Megjithatë, vetvetja e autorit ka një arsye për të qenë i kënaqur, sepse intelekti i një njeriu vërshon në kërkim të arsyeve, që kërkojnë mendime dhe mundim përfundimtar, mes kësaj ai merr lumturinë, për të takuar shpirtin e lirë. Këtë e shfaq kaq natyrshëm në strofën:

Shpirti im mi zgjidh mendimet / Tretëm në ëndrra që më japin kënaqsinë / Harroj prangat e jetës dhe detyrimet / Veç përmbur në ëndrra e njoh lirinë

Në përmbledhje: Autori na bën të arrijmë në përfundimin se, është shpirti që zgjedh me fjalë të tjera, se shpirti zgjedh shoqëruesit e tij historike dhe bashkëkohorë. Këta shoqërues janë njerëz të vërtetë, që kanë lënë gjurmë historike, që vijojnë të jenë edhe aktualisht, por ndër të tjera edhe një metaforë, për mendimet e autorit. Në secilin rast, shpirti, më pas “mbyll derën” përballë “shumicës antinjerëzore” dhe na jep ndër të tjera mesazhe me vlerë që të dimë të “Zgjedhim një shoqërues” nga “një komb i denjë me modele ndikuese në dobi njerëzore”, përpara se të mbyllë “Valvulat e vëmendjes së tij”.

Më interesantja, është se autori përdor një metaforë të zgjeruar, duke e krahasuar shpirtin me një shtëpi, me një vendlindje. Më konkretisht, shpirti duket se ka një shtëpi, me dyer, një portë dhe një rrogoz dere, por edhe shpirti duket se është ajo shtëpi, me fuqinë që t'i lejojë njerëzit në botën e saj të brendshme dhe t'i mbajë jashtë po ashtu. Kjo metaforë e shtëpisë, nga ana tjetër, pasqyron atë që autori percepton për shpirtin: si diçka të pavarur. Ideja e shpirtit dhe të paturit një shtëpi ngjall gjithashtu rehatinë simbolike dhe intimitetin e shtëpisë.

Në mbyllje: Ky libër është një poemë për fuqinë e një jete në lëvizje dhe kjo fuqi është e dukshme në vetë tingujt e strofave plot kuptim. Ka një aluzion të një pëshpëritjeje në ato tinguj: “Shpirti” që përshkruan autori është disi i turpshëm dhe i vuajtur, por gjithashtu i fuqishëm, në mënyrën e tij të çuditshme. Tingujt e përsëritur këtu bëjnë të duket sikur shpirti jo thjesht e mbyll derën me mirësjellje, por e mbyll aq shpejt sa lexuesi mund të dëgjojë flladin, duke fishkëlyer rreth skajeve të saj. Por ky sibilitet është gjithashtu i heshtur dhe privat, duke sugjeruar se ndërsa ka shumë gjëra që ndodhin pas derës së mbyllur të shpirtit, ajo ndodh vërtet në heshtje – dhe fuqia e tij mund të mos jetë gjithmonë e dukshme, për “Shumicën”, që qëndron jashtë dyerve të këtij shpirti. Për këtë, që ta kuptoni e ta interpretoni më mirë edhe në gjuhën e shpirtit tuaj, sugjeroj ta keni në bibliotekën tuaj librin “Flas me shpirtin tim”.

Duke e përgëzuar autorin e falenderoj për krijimtarinë dhe I uroj suksese të mëtejshme në rrugëtimin e krijimtarisë!

MENDIMI IM!

TONIN ARRINAJ

Te gjithë kemi degjuar këngën e Hajrefin pashës .Jo ma pak se 12 mij kan metë në istikame e në Dhe skan hi ...per mendimin tim ata 12 mij dele.....

Të dashur pjesëmarrës, njerëz të nderuar të letrave e dashamires të Artit, Ju falënderoj

për pjesëmarrjen tuaj. Keni lanë punët tuaja e keni ardhë.

Ju falënderoj me gjithë shpirtin tim!

Falënderoj ata djem, që u shprehen për librin tim .Falënderoj Shoqatën Atdhetare “:Dukagjini”, me kryetar zotin Ndue Sanaj dhe zonjushën Suele, moderatore.

Dua te them qe ky libër, me ka ardhë lirshëm sepse të gjitha motivet i kisha të shkruara në mend.

Kam shkruar, për pjesë të jetës sime ato më mbresëlënëse.

Në ato mbresa janë vendlindja ime, Dukagjini im, Shkodra e Atdheu im.

Ato qe kam ditur, që kam ditur për Dukagjinin mbi historinë e tij e traditat e tij.

Nga Dukagjini kam ikur fëmije, por në fakt asnjëherë skam mundur të iku prej tij.

Nga Atdheu kam ikur i ri, por asnjëherë skam mundur te ndahem prej tij.

Largësia nuk të largon, prej atdheut; ndërsa Indiferenca po.

Kur isha fëmijë, me pyesnin nga jeni? Ju thosha, jam nga Dukagjini. A prej Dukagjinit jeni?- e fytyrat e tyre tregonin fatkeqësisht ironi. Më vonë kuptova që ata që ma shanin Dukagjinin ju mungonte diçka që nuk e kishin si dukagjinasi e mi. Sa më shumë, që ma shanin aq më shumë fillova ta dua.

Identike, më ka ndodhur me Atdheun.

Në ato vitet e para të emigrimit t'u thoshe se jam shqiptarë ishte njësoj si t'u thoshe kam kolerën.

Kuptova, që kishin diçka më pak se, ne shqiptarët e sa më shumë, që ma shanin aq më shumë fillova ta dua!

Kuptova, që ju mungonin disa gjëra në dukje të thjeshta si zemërgjerësia, respekti e vendosmëria!

Dukagjinasi!

Dukagjinasi është i vendosur. Kur vendosë të bëje diçka si për mirë dhe si për keq e banë dhe nuk pret çastin që ta bëje. Nuk thotë, do e bëj javën tjetër e pastaj javën tjetër, e bën dhe pikë...

Ketë vendosmëri e kanë më shumë shqiptarët sesa popujt e tjerë !

Dalëngadalë gjërat filluan të ndryshojnë, por fal vendosmërisë sonë!

Ndryshuan dhe opinionet e ngriti krye respekti.

Kuptuan që nuk jemi një popull injorantesh, por një popull me djem e vajza të talentuar e me plot pasione.

Kuptuan, që prapa paraqitjes së njerëzve të “forte” ishim një popull me mjaft dhembshuri e me rregulla të respektit, që ata i kishin harruar.

Filluan të na duan!

Kjo gjë po ndodhë, për fat dhe me Dukagjinin .Opinionet dalëngadalë po ndryshon.

Kanë kuptuar që Dukagjini, nuk është një zonë që nëpërkëmbët, por është një zonë me plot njerëz të talentuar, të dashur e me një bujari të pasoqe.

E për mua Dukagjini, është një dashuri, e më shumë se një dashuri, është një dhimbje.

Dukagjini është i dhimbshëm.

Atdheu vete, është i dhimbshëm. Më është dashur të largohem prej tyre, që ta kuptoj sa më mungojnë. Më mungojnë aq sa vetëm ata që kanë emigruar për një kohë të gjatë si unë e kuptojnë .

Të tjerët jo fatkeqësisht!

Por të vijmë tek libri: .libri im ka vetëm dashuri, ka dhe kritika, por kurrë urrejtje!

Ka dashuri për Thethin, Dukagjinin, zonën time dhe për Shkodrën, qytetin

tim.

Shkodra!

Shkodra, është qytet i bekuam prej Zotit, ai e ka shpall qytet të përjetshëm! E kush e ka pa e nuk e ka dashtë?

Shkodra të banë për vete!

Nuk dua të zgjatem e të them se çfarë është Shkodra. Fatkeqësisht, Shkodra ka një armik që kurrë nuk ra dakord me POLITIKËN.

Kurrë nuk ra dakord totalisht me te edhe kurrë politika nuk e deshti Shkodrën. Shkodra i ka dhanë provat e veta si ndaj Atdheut, si ndaj politikës sa askush tjetër e ka marrë nga politika, më pak se askush tjetër.

Turp për politiken!!!

Por Shkodra mbetet Shkodër, nuk ka fjalë tjetër për te.

Gjithkush e dine, se çfarë është Shkodra e çdo kush e dinë që herët o vonë, do marrin atë që meriton.

Fronin e mbretëreshës!

Ajo i ka të gjitha armët e duhura, Histori, Art, Kulture, sport, talente, dije dhe e bukuri. Këto janë armët e saj e do dijë si gjithmonë ti shpalosin. Fatkeqësisht as ne emigrantët kurrë nuk u ndjemë të mbrojtur nga politika.

Kurrë nuk u ndjemë të mbrojtur nga politika!!!

Por Shkodra ashtë një dashuri!

Cili emigrant kur kalon urën e Boçallekut nuk kthehet ta shohin dhe njëherë kështjellën e “Rozafës”?! .Sa prej tyre e kanë pa për here të fundit, sepse nuk janë kthye më!

Në librin tim kam fole për emigracionin, për ato çka kam përjetua personalisht e kam pa tek të tjerët

Fatet e shumicës pothuajse ishin të njëjta, mall, vuajtje e fatkeqësi.

Emigrimi, më besoni asht një shkollë.

Në jetë provova zhgënjimin e atij, që të thoshte të dua si vëlla. Provova zhgënjimin e atij, që të thoshte kij besim tek unë. Mësova, që e vërteta me fjalët nuk bënë të njëjtin hap. Mësova, që kur jeni në hall shoqëria pothuajse nuk ekziston. Duhet, që kur të rrezohesh të çohesh vetë. Mësova, që njerëz që hiqen si të mençur mendojnë, që të tjerët janë budallenj.

Mësova, që njerëz të shkolluar ju mësojnë të tjerëve injorancë dhe njerëz më me pak shkollë, ju mësojnë të tjerëve edukatë. Mësova, që ai që më fliste keq për ty, të fliste dhe ty keq për mua.

Atëherë, mësova të them, që jam mire dhe pse kisha dhimbje në shpirt. E mësova, që ata që më ndihmuan nuk duhej ti harroja kurrë. Mësova, që fitorja më e madhe për një njeri është të mposhtin mendimet negative, veç atëherë ke njohur paqen e shpirtit!!! Mësova, që kurrë nuk duhej të harroja vendlindjen time, Dukagjinin e qytetin tim et rinisë, Shkodrën time.

Një vëlla meh ka thanë se, ndoshta e ke teprua me dashuri, unë i them se me dashuri pothuajse nuk teprohet kurrë, me urrejtje po .Për mua s'ka fjalë, që e shprehë dashurinë për Shkodrën, për Dukagjinin e për atdheun. Veç fjale të mira më nxjerrë shpirti e nuk di të ndalem.

Një frazë e vetme, një strofë e vetme sikur gjithë mençurinë e botes ta fusësh nuk e shprehë dot dashurinë që një emigrant si unë ka për Shkodrën e vendlindjen. .E unë, duke mos e gjete atë fraze e atë strofe,

jam zgjate, e jam zgjate hajt edhe një hajt edhe ketë. Nuk mendoja, që do dilte një libër kaq voluminoz, por mendoja se do dilte sa gjysma e tij. E fajin ma ka dashuria e plot malli. Asnjë qytet në botë as Napoli nuk merr aq dashuri nga qytetaret e saj sa Shkodra .Mund të jetojnë në Paris, Londër, Romë, Milano e kudo në botë, kur i pyet nga jeni dhe të përgjigjen (prej Shkodrës), e duket se heqin diçka prej shpirtit. Në ato dy fjale ka aq dashuri aq mall e krenari.

Fëmijërinë e kam kalua në Dukagjin, aty jam bë 15 vjeç. Kam pas fatin e mire, që shtëpinë e kulturës ta kem veç 50 m prej shtëpisë. Aty mblidheshin gjithë artdashësit e Dukagjinit, instrumentistet, këngëtarë, valltarë e njerëz të tjerë, që kishin dëshirë të kalonin kohën me biseda, këngë e valle. Kam kenë një fëmijë kërkues dhe më pëlqenin këngët e vjetra e çdo gjë që fliste për historinë e Dukagjinit. I dëgjoja me kureshtje e mundohesha ti përsërisja me mend. Jam mundua, që ti fusja në librin tim për aq sa më kujtoheshin. A janë e njëjta gjë? Jo. Duke mos i kujtua mire jam mundua të shtjelloj idenë e atyre këngëve Por jam mundua. Këngët e librit tim janë bazuar në gojëdhëna balada e legjenda e jam krenare, që jam mundua ti përcjelli tek et tjerët, .sepse për Dukagjinin është fole aq pak e është shkrua aq pak, sa nuk mund të mendohet. Kam kërkua te gjej materiale, jam mundua e kam gjetur pak, duke mos pasur mundësi të tjera, pos atyre autodidakteve kam pas vështirësi. E ata që i kanë këto mundësi i gjënë në lokale e nuk bëjnë punën e tyre. Në librin tim kam shkruar për ngjarjet historike e figurat kryesore të historisë së Dukagjinit. Kam folur për të gjithë? Jo. Do ishte e pamundur në një libër të vetëm.

Shpresoj me zemër, që dukagjinasi të tjerë ta vijojnë gjithë linjën e heronjve të Dukagjinit, dhe pse janë heronj dhe pse askush se ka marr mundimin ti shpallin zyrtarisht.

Nuk mundet kurrë, që historinë e Dukagjinit ta shkruaj një person, që ka lind në Delvinë o Gjirokastrë. Duhet ta shkruajmë vete historinë tone. E për deri në luftën e Dytë Botërore kemi seç të shkruajmë ma shumë se te tjerët.

Lufta e Dytë Botërore ishte një katastrofe për historinë e Dukagjinit, duke mos u shpallë as majtas as djathtas, as me komunizmin e as me pushtuesit, në veç 4 vite humbëm 2000 vjet histori. Ramë në pus të pafund. Na bane shembull për keq.. Në Malësinë e Madhe veç arma na e pat majtë në krye të vendit dhe kur i ulëm armët kaluan mbi ne ata që nuk i njihte kush.

Historinë tonë e shkruan të tjerët, sipas qejfit të tyre. Ata ngritën në qiell historinë e tyre. Banë heronj deri ata, që i vranë vetë me dorën e tyre. E as Dukagjini e as Malësia e Madhe pothuajse nuk kishin ma heronj. Kjo, më ka be të flas me shpirtin tim.

Përmbi 60 vjet dëgjuam sa e sa këngë për heronjtë e tyre të rreme e histori të rreme. Të gjithë kemi dëgjuar këngën Martaneshi vend i mirë, s'duron Pashë s'duron Vezirë. Atëherë unë kam thane, kur Martaneshi krahina ma fetare e Shqipërisë s'paka durua Pashë e Vezirë çka duhet të shkruaj unë për Dukagjinin tim? me lindi dëshira të fus në librin tim këngën e 7 shaljanëve. Ashtu siç e kanë këndua shaljanët, secilit prej

SHKODRA DHE MALËSIA E PRESIN ME RESPEKT DHE E PËRCJELLIN ME MIRËNJOHJE Z. NDUE FTONI

Pas rreth pese viteve Ndue Ftoni vjen në Shkodër, me datën 13 maj 2024 dhe largohet pe në Miçigan, me 20 qershor 2024, mbi një muaj në qarkun e Shkodrës, në Shkodrën e zemrës së tij e të familjes.

me u kënaq me familjaret e tij, me miq e shokë, me vendin, që malli ishte i pafund

Ketë mall e dashuri për miqtë e shokët e bëri realitet me një here, duke i bashkuar në qendrën kulturore "Në Art Center Blu-Skay", mbi 100 vete deri personalitete të artit e kulturës, këngëtar, valltar, instrumentist, humorist, veprimtar të fushave të ndryshme e të tjerë e të tjerë, dhe në mes tyre: Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, z. Gjergj Leqezja, Kryetari i Unionit Artistik Shqiptar, z. Azgan Haklaj; këngëtar i mirënjohur Hajro Pepa, humoristet me Besnik Qinarin në krye, bejtexhiut me në krye Bujar Zuralin, grupi kulturore "Treva", me në krye kanautorin Fran Kodrën, grupi folklorik "Besa e Shoshit", me në krye rapsodin Ndoc Fushën, anëtar të kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me në krye Kryetarin e saj, Ndue Sanaj (Kolë Çardaku, Roza Pjetri, Dukate Bregu, Prele Shytani e Gentjan Gropa) e të tjerë e të tjerë, kryesisht nga trevat e Veriut ...

Në këtë takim jo vetëm çmallje nga organizatori Ndue Ftoni, por dhe ne, pjesëmarrësit u çmallem me njeri - tjetrin, se atmosfera ishte e veçantë, e papërsëritshme.

Takimin e hapi gazetarja e mirënjohur Linda Kavaja, e cila pasi uroj mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe uroj Ndue Ftonin për këtë nisem të veçantë, i dha fjalën, e përshëndeti po të thuash të gjithë pjesëmarrësit emër për emër, duke i falënderuar për kohën shumë të çmuar, që më keni kushtuar ... Ju falënderoj dhe Zoti ju bekoftë!

Linda vijoi prezantimin e drejtimin e kësaj darke të veçante, duke u dhanë fjalën këngëtareve, si Hajro Pepa, Viola Shqau, Ndue Shytani e Fran Kodra, poeti Lulash Brigja, këngëtarëve nga Vau Dejës, por pati dhe valle e përshëndetje nga pjesëmarrësit, si Azgan Haklaj, Ndue Sanaj, Viola Shqau, Bujar Zurali, Gjon Marku, Pal Shkami, Gjon Dukgilaj, e të tjerë e të tjerë.

Kjo darke e veçantë e organizuar nga Fisniku Ndue Ftoni, rreth mesnates mbyll dhe dolëm, me mbresa të jashtëzakonshme, duke i thane Ndue Ftonit, me urimin "Tu rrit ndera Miku i ynë, Ndue Ftoni!"



Në festen e "Çobanit", në Okol të fshatit Bogë, me 15 qershor 2024

Ndue Ftoni gjithmonë shtron darka me miq e shok... Ai, është një njeri me zemër të madhe, shpirt madh dhe fisnik, shprehet një mik i tij dhe ku pata rastin të jem në Amerikë dhe menjëherë me bëri ftesë si mik, në shtëpinë të tij, në Miçigan .

Selami Fadili, do të shprehej: Të falënderoj Ndue Ftoni, për mikpritjen, bujarin dhe respektin, të cilat nuk me munguan nga ana e juaj dhe familjes tuaj, që kur u njoftim para 38 viteve dhe sot si shok dhe si vëllezër me njeri-tjetrin .

Luc Balaj, do të theksonte: "Mbrëmje festive nga miku i ynë Ndue Ftoni, me banim në Miçigan, në Art centë blu Sy. T'u rrit ndera Miku i im Ndue Ftoni!"

Ndue Ftoni kudo takime me miqtë e miket e tij:



tyre një për një sepse ashtu jua kërkonte ligji i pashkruar, i nderit familjar dhe pse ajo më shumë, se një kënge është një baladë e gjatë e dimrave të ftoftë ashtu siç është këndua në Dukagjin. Kënga e 7 shaljanëve është më se e vërtetë, sepse ka dëshminë e Deli Pjetëres, që e mohoj e ama, e mohoj dhe Dukagjini, për ata tashmë ishte i vdekur .U kthye në Shkodër me vdekë dhe ai si Hero. Të gjithë kemi dëgjua këngën e Hajredin Pashës ... Jo ma pak se 12 mijë kanë metë në istikame e në Dhe s' kanë hi.

Pra, dibranët paskan vra 12 mijë turq. Ata 12 mijë dele sikur ti kishin vra do i kishte zan gjaku. Më falni, por mua më duket diçka e paarsyeshme.

Vetëm në luftën e Nikçit, Shala, Shoshi e Kelmendi shpartalluan një ushtri prej 8 mijë trupash turke, nisë nga Peja në drejtim të Shkodrës. Mbeti veç statistikë në arkivat e shtetit. Asnjë këngë, asnjë mburrje dhe pse u lame me gjak grykat e Nikçit. E kush ishte si Dukagjini para luftës së Dytë Botërore, askush. Dukagjini ndihmoi jo veç Kelmendin, por dhe Malësinë

e Madhe si në kodra të Mocketit, në Daci, në Tuz, në mbrojtje të Plavës e Gucisë, shkuan në ndihmë të Krasniqes e të Mic Sokolit. E kush e ndihmoj Dukagjinin? Askush! .Kush e ndihmoj Dukagjinin, në qafën e Agrit? Askush! Po në qafën e Boshit, në Plan-GJuraj, në Tëtherme, në Gurë të Kuq e në qafën e Kolçit? Askush! I doli zot vetes e nuk e ndjeu nevojën të mburrej e quajtën thjesht dëshirë, për mbrojtjen e dinjitetit shqiptar.

Asnjë mburrje!

E s'po flasim për të tjera si marrja e

kështjellës Rozafa". O hyrja në Tiranë, që e detyroj Zogun të largohet përkohësisht nga Tirana.

As dhe një mburrjeje, këna gabua?!

Duhej dhe ne të rrihim gjoksin. Këna gabua?! E pra, këto janë të vërteta historike! Rendësi ka që Dukagjini, me djemtë e bijat e tij të talentuar ta shkruajnë historinë e tyre, disa prej të cilëve janë këtu e na nderojnë.

Unë besoj tek ju. Besoj në ata që vijnë pas nesh.

Ju falemi ndërse!

Takime, respekte e ceremoni e veçantë për Ndue Ftonin!

*Kryetari i bashkisë së Malësisë së Madhe, z. Tonin Marinaj i ka dorëzuar sot, titullin e nderit "Çertifikatë Mirënjohjeje" z. Ndue Ftoni, me motivacionin: "Për kontributin e çmuar të dhënë si biznesmen në SHBA, ku ka treguar respekt e vlerësim me punën e tij nëpërmjet pasqyrimit të vlerave të Malësorëve në ACTV. Ka punësuar qindra malësore në biznesin e tij në SHBA"

*Në kuadrin 146 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Shoqata "Malë-

sia" dhe Klubi "Letrarë i Shkrimtarëve, Poetëve dhe Artistëve të Veriut", në qendrën "Arka "Koplik, organizoi takim me intelektual në nderim të figurave të rezistencës si Haxhi Zekë Peja, Abdyl Frashri dhe shumë përkrahëseve nga gjithë trevat Shqiptare.

Me këtë rast, gjithashtu Ambasada Botërore e Paqes me qendër në Tiranë i jep çmimin "Ambasador Paqeje Botërore, për të Drejtat e Njeriut" shqiptaro-amerikanit z. Ndue Ftoni, me banim në Miçigan.


Me këtë rast, një dreke e shtruar për nder të Ndue Ftonit nga kryetari i bashkisë Malësi e Madhe, z. Tonin Marinaj dhe z. Mark Babani.

Të gjitha këto takime e nderime, janë vijues e nderimeve të mëparshme:

Ndue Ftoni ka titullin "Mirënjohja e qytetit të Shkodrës", "Qytetar Nderi" i Gruemirës e i Rrethinave, "Krenaria e Qarkut Shkodër" dhe titullin "Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini". Pra, men-

doj se të gjitha këto nderime, të gjitha këto vlerësime kanë një përmbledhje: "Ndue Ftoni meriton të theksohet, se Bujaria ka lind me Ndue Ftonin, ose Ndue Ftoni ka lind me Bujarinë!"

**REDAKSIA
E GAZETËS "DUKAGJINI"**



Gjokë Luli, cicëroni i historisë lavdiplote të një treve traditash

Gjithnjë kur ndërmerr një rrugëtim dhe dëshiron të vizitosh një zonë, në themelet e së cilës qëndron kureshtia njohëse për historinë, personalitetet përfaqësuese të kohëve dhe sfidave, gjithashtu dhe traditës, dokeve dhe zakoneve, ajo që do të ishte udhërrëfyese për këtë aventurë, është hedhja e një vështrimi paraprak në materialet e publikuara, ku flitet për vendin e piketuar të vizitosh. Por gjithë kjo nuk mjafton. Këtë do ta kuptosh kur të takosh Gjokë Luli, i cili është një enciklopedi e këtyre anëve, por përmbi të gjitha ai e ofron këtë shërbesë me një dashamirësi dhe përgjegjësi malsore dhe intelektuale, dinjitetshëm dhe fisnikërisht.

Ndalesa e radhës në eksplorimin e epikës malsore ishte Bajza e Kastratit, Malsi e Madhe. E gjetëm Bajzën atë mesditë mestetori të larë nga një diell që vështronte me dritë panoramën që shpërfaqej në qetësinë e një fundjave. Aty ku rrënjët e një legjende shuanin etjen te një pus i pagëzuar "Shpella e Frashnit", aty ku dy luftrat e Mosketit përjetësoheshin në një monument, na pristë Gjokë Luli. Si një cicëron që kërkon të mbushë me dritë vështrimet kureshtuese të vizitorëve, ai menjëherë nisi të ligjëroje, si në një dëshirim për ta bërë praninë tonë pjesë e këtij vendi, e këtyre njerëzve, e kësaj historie.

Bajza përfaqësohet prej Gjokë Lulit si prej një vendasi që flet me dashuri për gjithçka. Ai u bë zëdhënësi i heshtjes së kohës dhe viteve, me të njëjtën forcë besimi dhe qëllimi, i cili kishte mburjtur lëndën... që jetën, gjakun dhe sakrificat e gjithë atyre njerëzve dhe brezave, ta shndërronte në një përmendure kujtese dhe mirënjohjeve. Gjoka, fliste dhe vetëm fliste me një pasion dhe përkushtim si në një akt ceremonial transformimi të së shkuarës në të tashmen pjesë e së cilës u bëmë edhe ne.

Çdo pyetje e jona merrte një përgjigje dhe çdo përgjigje e Gjokës merrte zë dhe shpirt prej tij, duke u bërë ngjarje, e cila shpërfaqej imagjinatave para nesh, duke i dhënë kësaj vizite dhe këtij rrugëtimi statusin e një rijetësimi në kohë dhe njerëz.

Ai na tregoi për luftërat e përgjakshme, përpjekjet ngadhënjuese, për qëndresën dhe sakrificat e malsorëve, ashtu siç me zell dhe admirim ai foli për njerëzit e artit dhe shpirtit krijues, përfaqësuesit e denjë për mirënjohje, të cilët kudo që sfida i kishte çuar, ata kishin dëshmuar për forcën, vitalitetin dhe një shpirt të pasur malsori, duke përfaqësuar jo vetëm veten por edhe Bajzën, Kastratin, Malsinë e Madhe.

E dritshme ishte ajo ditë fillimvjeshte në Bajzë dhe mbeti e tillë përgjatë gjithë atyre minutave dhe orëve të rrugëtimin tonë nëpër malsi, rrethekrah ku kishte kujtesë dhe ngjarje, histori dhe bëma. Gjokë Luli, ai burrë i moshuar që na tregoi me hov rinie gjithçka që na bëri pjesë një softe bujare që gjetëm shtruar në Malsi.

Në këtë rrugëtim të mallshëm, krahas njohjes me çdo gurë, mur e kullë të kësaj ane, dëgjuam për histori epike lirie dhe besimi, zakonesh dhe tradite, shfletuam faqe historie e bëmash lavdiplota malsorësh, jeta e të cilëve u ngjiz në këto gurë e shkrepa, në këto male e faqe kësaj magjie eposi, dhe u lartësua në vepra të

hirshme dhe heroike, krenaria malsore. U bëmë çast dhe kujtesë e gjithë atyre viteve dhe shekujve, në epikën e këtyre shkrepeve dhe madhështinë e atyre përpjekjeve që dëshmuuan ngadhënjues malsorin dhe gjithçka që lartësoi atë sa këto male.

Me përkushtimin dhe devotshmërinë e një vullneti të denjë për besim që

për të shkruar histori gjaku dhe qëndrese, për të enduar flamuj lavdie dhe shpalosur mishërim vlerash dhe virtytesh, sikurse për të parë dhe për tu magjepsur me eposin dhe bukurin e të njëjtit rrezatim, si të malsores ashtu edhe të xhubletës, kësaj pasurie shekullore që përfaqëson shpirtin e pasur dhe vlerat e pakrahasueshme të një tradite që u kthye në thesar.

Shkuam atje ku kishte mbërritur me lavdi lahuta, kënduam me melsorët dhe jehonat e maleve, e kjamë me Iliadat dhe vajtoret, si në një ceremonial të hyjshëm përjetimi të atyre çasteve të ndarjes që ngjizin me tharm përjetësinë e skalitur në kujtesë dhe nderim.

Gjokë Luli pati mirësinë bujare dhe vullnetin e mirë të na çonte krejkund deshëm me kaq papërtesë e zell tregimtari, duke ndarë me ne gjithçka ku kryenalt qëndronte malësia.

Kudo që shkuam dhe gjithçka që mësuam, s'mund të iknim nga Bajza pa marrë me vete edhe njohjen me Gjokë Lulin, cicëronin tonë, njeriun e mirë të Malsisë, atë që kaq modestish tregoi për veten, atë solemnitet që është shpirt malsori.

Gjokë Luli u lind në Bajzë të Kastratit më 19 qershor të vitit 1949. Ato 72 vite ai i kishte mbushur me lëndën e pasur të malsorit. Çdo pasion dhe përkushtim i tij ishte rritur e mëkuar prej atij shpirti deri në caqet e veprës, asaj të publikuar që pikas me librin "Kastrati" një vepër e trajtesave shteruese të manifestimit njohës të kësaj zone në të gjithë rrafshet e saja, dhe asaj veprë në dorëshkrim. Krejt këtë ai e ka mëkuar me ngulmin dhe zemrën për të dhënë e për të thënë atë çfarë është e asaj rëndësie që kërkon përfaqësimi, mbrojtja dhe promovimi i atij amaneti që etërit kanë lënë brezave. Gjokë Luli e mban me përgjegjësi dhe krenari këtë barrë të rëndë të përmbushjes së atij besimin që për të dhe për çdo malsor është atribut i lartë.

Gjoka përgjatë gjithë atij pelegrinazhi nëpër Bajzë e Kastrat dhe jo vetëm, nuk reshti së rrëfyeri dhe bashkëndari me ne të çdo historie dhe legjende që lidhej me vende e me njerëz, dhe ajo që e dallon këtë cicëron është pasioni, me të cilin ai e ndau me ne atë që për të ishte dije dhe për ne mbeti admirim, dhe e bëri këtë me një qasje për të rijetuar, në një kohë tjetër zhvillime dhe ecuri ngjarjesh dhe episodesh që hynë nga porta e madhe e historisë, për t'i ngjitur lart në qiellin e epikës dhe legjendës.

Vitet e shkuara nuk e ndaluan për asnjë çast Gjokë Lulin të dëshmonte me energji drite dhe ngjyrash gjithë tablonë që ai e stolisi para ëndjes sonë. Çdo gjë që ka dashur dhe ka bërë Gjokë Luli është përpjekja e një vullneti që modestish tregon vetveten përmes asaj çfarë ai shkruan për kujtesën e këtyre maleve dhe kësaj malësie dhe çdo gjëje ku pulson kjo quenësi për vëmendje dhe vlerësim.

ALBERT VATAJ



paimagjinueshme qëndrese dhe lufte për liri dhe nder, besë dhe besim, flamur e atdhe.

U takuam dhe pjesëmorëm në të gjitha epopetë ku qëndron si një maje e lartë, e

karakterizonte Gjokë Lulin, bëmë një ekspozitë të gjithë asaj që është malësia. Një për një përmendëm emra dhe gojtari, ngjarje që u ngjiten në legjendë dhe heronj që zbritën nga malet si nga retë

NJË TJETËR FESTË IU SHITUA KALENDARIT KULTUROR NË MALËSI TË MADHË FESTA E ÇOBANIT MES MALËSOREVE TË BOGËS

Agroturizmi "Buni & Kulla e Bajraktarit me mbështetje të Ministrisë së Turizmit dhe Miedisit,

në bashkëpunim me fermerët, dhe blegtorët e zonave alpine, shoqatat kulturore dhe artistët e artit burimor rrëzë Alpeve Shqiptare e jo vetëm, në kuadër të nismës "Trans'humanca Identitet Kulturor Kombëtar" e mbrojtur nga UNESCO organizuan manifestimin kulturor 2 ditor "FESTA E ÇOBANIT MES MALËSOREVE TË BOGËS".

I gjithë organizimi festiv ishte i lidhur ngushte me Xhubletën në prehrin e së cilës u rriten dhe trashëguan në shekuj këta çoban (barinj) rrëzë Alpeve Shqiptare. U rriten dhe fisëruan, u burruan dhe plakën krah xhubletës malësore, të vlerësuar po ashtu nga UNESCO si pasuri botërore unike në llojin e saj dhe certifikuar si trashëgimi kulturor kombëtar shqiptar.

Ky manifestim kulturor përkoji me shtegtimin dhe mbërritjen e bjeshkatarëve në bunishtë, sheshin ku çobanët kanë ndërtuar dhe trashëguar në shekuj t' banet (stanet) e tyre, të cilët në mënyrë të përsëritur rikthehen në këto vendbanime të përkohshme për të përmbushur nevojën për kullota të bollshme, për të siguruar bulmetin e dimrit për familjet, shëndetin dhe mbarëshkrimin e gjësë së gjallë.

I gjithë manifestimi kulturor i rijetëzimit dhe promovimit të kësaj tradite të lashtë në bjeshkët tona e cila na dëshmon vlerën e punës së çobanëve, vështirësitë dhe sfida të këtij shtegtimi bjeshkë - vrrit, krijon premisa të jashtëzakonshme për zhvillim të qëndrueshëm rural dhe na mundëson të promovojmë edhe resurset natyrore, pasuritë kulturore e shpirtërore, gastronominë dhe prodhimet vendase. Gjithashtu ky manifestim gjithëpërfshirës nxit dhe zhvillon turizmin kulturor dhe malor si degët më sencibël për zhvillim ekonomik, sidomos në këtë periudhë të vitit që përkon edhe me fillimin e sezonit turistik veror.

Në këtë manifestim kulturor të pranishmit patën fatin të shohin nga afër lëvizjen e karvanëve dhe të gjithë gamën festive e cila lidhet me aktivitetin e punës dhe jetës së bjeshkatarëve si një ndër arritjet më të rëndësishme kulturore që dëshmojnë lidhjen e njeriut me natyrën. U demonstrua dalja në bjeshkë e karvanëve, e respektimit të distancës mes tyre, konkursi i prijës të kopësë të cilin e gjykoi një juri profesioniste ku ishin të përfshirë çoban në moshë, Islam Mataj - Kryetari, Gëzim Laçi - anëtar,

Çel Lisi - anëtar, Shtjefen Ujkaj - anëtar. Fitues të konkursit u shpallën dy ogiçet e bjeshkatarit nga Thethi Lucë Fran Çarkut,

të cilët përfituan edhe një vlerë monetare si dhe çertifikatën e pjesëmarrjes.

Ky projekt kulturor i rëndësisë së veçantë, synon të rikthejë në identitetet jetën baritore të blegtorëve tanë dhe të shpallë pasuritë agrokulturore që të ofrojnë bjeshkët tona. Në program pati të gërshtuara aktivitete të shumta kulturore aq sa bjeshkët të gëzojnë një festë të vërtetë. Projekti i pagëzuar me titullin "FESTA E ÇOBANIT MES MALËSOREVE TË BOGËS" dhe ideuar nga malësori dhe biznesmeni i suksesshëm, pronari dhe presidenti i Agroturizmit "Kulla & Buni i Bajraktarit" kishte qëllimin e mirë, që ti japë një faqe të re zonës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e kulturor ndaj duhet vlerësuar edhe për vizionin e tij largpamës.

Ky projekt pati një impakt të jashtëzakonshëm, aq sa të marre vëmendjen e gjithë opinionit publik shqiptar, brenda dhe jashtë kufijve, pasi në këtë manifestim kulturor ritualet baritore rikthyen në kujtesën e shumë malësorëve nostalgjinë e ÇOJËS së bjeshkatarëve.

Si regjisorë e këtij aktiviteti kulturor, gjej rastin të falënderoj nga zemra z. Gëzim Olaj President i Agroturizmit Kulla & Buni i Bajraktarit që ma besoi mua ta ideoj dhe realizoj gjithë këtë manifestim të pasur me vlera të jashtëzakonshme kulturore e shpirtërore, materiale dhe jomateriale të bjeshkatarëve rrëzë Alpeve Shqiptare. Aktiviteti i cili hodhi shtat pikërisht në shtazanin e vërtetë të t' bjeshkuemit të malësorëve duke i dhënë kuptim festës dhe kohës në të cilin u realizua, çka na motivon për ta kthyer në një festë tradicionale në Malësi të Madhe.

Falënderoj nga zemra të gjithë jurinë dhe bjeshkatarët që pranuan të bashkëpunonin me ne në manifestimin e "Daljes në Bjeshkë të Karvanëve" me tufat e bagëtive, si dhe konkursin e "Prijës të Kopësë".

Në rolin e regjisorës falënderoj nga zemra të gjitha grupet folklorike pjesëmarrëse në këtë manifestim të bukur kulturor: Ansamblin "Rugova", Grupin folklorik "Jehona e Kelmendit", Folk-Grup "Bilbili", Shoqërinë Kulturore "Logu i Bjeshkëve", Grupin folklorik "Fidanishtet e Folklorit", këngëtarët: Nikollë Nikprellaj "Mjeshtër i Madh", Zef Beka dhe Vida Kunora, rapsodët: Pjetër Matusha e Xhavid Balidemaj, këngëtarët e vegjël Valon Gjolaj dhe Leo Masheqaj, aktorin dhe regjisorin Kolë Kunora.

Një falënderim e mirënjohje zemre kam për Ansamblin "Besa" e Trieshit, për bashkëpunimin dhe mbështetjen e pakushtëzuar në këtë manifestim maratonë tejet të rëndësishëm kulturor baritor.

Një falënderim të sinqertë kam për



Momenti, që Presidenti i Agrobiznesit, z. Gëzim Olaj, me drejtuesen Kozeta Bruçi, duke shpallur fitues të konkursit dy ogiçet e bjeshkatarit nga Thethi, Lucë Fran Çarkut, të cilët përfituan edhe një vlerë monetare si dhe çertifikatën e pjesëmarrjes

mediat dhe gjithë miqtë e dashamirësit të cilët e promovuan këtë manifestim në formën më të mirë të mundshme.

Kam kënaqësinë dhe detyrimin të falënderoj me zemër moderatoren e mrekullueshme znj. Kozeta Bruçi për këtë bashkëpunim kaq të suksesshëm dy ditor, e cila me profesionalizëm dhe shumë oratori arriti të menaxhojë me saktësi të gjitha aktivitetet e përfshira në këtë manifestim kulturor.

Një falënderim të përzemërt për gjithë stafin e punës së Agroturizmit Kulla &

Buni i Bajraktarit, për mbështetjen dhe gatishmërinë për bashkëpunim në këtë aktivitet.

Faleminderit të gjitha bizneseve dhe fermerëve mbështetës.

Shumë faleminderit të gjithë pjesëmarrësve, turistëve dhe miqve të ardhur enkas për këtë manifestim kulturor.

**Përgatiti: RITA SHKUERAJ,
Kryetarja e Shoqatës Kulturore
"Xhubleta e Alpeve Shqiptare"**

PROGRAMI Dita e parë, datë 15.06.2024	PROGRAMI Dita e dytë, datë 16.06.2024
<p>Ora 11.00 - 12.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Demonstrimi i shtegimit të bagëtive - Jehona e mbërritjes së karvanit - Tesha e mirë e çobanëve (shkarkimi i karvanëve) <p>Ora 12.30</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasurimi dhe përshatja e thanit (stanit) muze me elementet bazë që sollën karvanet të cilin mund ta vizitohet të gjithë të pranishmit <p>Ora 13.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përhëndetja nga organizatorët & çelja zyrtare e festës së bjeshkatarëve <p>Ora 14.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konkursi i prijës të kopësë (ku çobanët do të konkurojnë me deshtë dhe cjepët e tyre për të vlersuar racën më të mirë autoktone. <p>Ora 15.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i madh festiv me motive baritore "Dola n'bjeshkë se erdhi vera" ku do të performojnë live dhe do ta ndezin atmosferën festive këngëtarët e suksesshëm, ikona të artit burimor, Vida Kunora, Zef Beka, Rapsodet Pretash Nilaj, Pjetër Matusha, Xhavid Balidemaj, Nikollë Nikprella, Ansambli "Besa" e Trieshit, Ansambli " Rugova" SHK "Logu i Bjeshkëve" SHK. "Maja e Karajfilit" - Plavë - Guçi. Grupi Artistik " Fidanishtet e Folklorit". SHK "Jehona e Kelmendit" si dhe shumë rapsodë e artistë të folklorit <p>Ora 20.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndezja e zjarreve <p>Ora 21.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në respekt të miqve dhe turistëve në monitorin e madh të skenës do të transmetohet ndeshja Shqipëri -Itali e cila do të shoqërohet edhe darken festive. <p>Ora 23.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuvendi i çobanëve (mbas darke) <p>Ora 24.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bujtja në konakun e çobanit (shpërndarja nëpër bujtina) 	<p>Ora 10.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çelja e aktivitetit. Përhëndetja nga organizatorët. - Përkshkrimi promocional i sponsorëve, agrobizneseve mbështetëse të panairit . <p>Ora 10.30</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hapja e panairit të pasur me produkte të larmishme vendi nga puna e çobanit dhe çobaneshës. (Bulmeti dhe biodiversiteti i gatimeve tradicionale). - Gostia e çobanit (mish ferliku, tanel e borë, mish e n' tanel, mazë çapre, kaçmak, mish e n' krane, djathë pluge, mishavinë, etj.) - Gostia e çobaneshës (petulla me mjalë, djathë të ziem, jardu, kos bjeshkë, kulaç kukini, bukë votre, bukë misri, kertolla n' thyë, maza e re, thyë tpi, kjuvsh, jardu, mazë e vjetrumë, etj) - Ka ra mjalta n' gjet e n' lule. "Gostia e hojeve" (mazë hojesh, dyll zgualli, mjalë me penolla, mjalë me mazë e bukë) - Strajca e çobanit (çantë e personalizuar të cilën turistët mund ta blejnë me ditë nga prodhimet vendase me një kosto minimale) - Çelja e Thanit Muze, ku do ekspozohen elemente bazë të jetës dhe të punës së çobanit bjeshkatar. <p>Ora 11.00</p> <ul style="list-style-type: none"> - Koncert festiv me këngë, valle e instrumentale me motive baritore me çakçir e me xhubleta të ofruara nga fondi i veshjeve të SHK "Xhubleta e Alpeve Shqiptare". - Në koncert festiv do të performojnë përsëri këngëtarët dhe grupet e mirënjohura, ashtu si në ditën e parë "Dasëm në Bjeshkë" do që jetë festa madhështore në vazhdim "Po martohet malësori, Improvizim i dasmës malësore "Erdhi maza: Rituali i molles, Rituali i gacës, Djali i prehrin, Zblimi i duvakut, T'shëtrrit rreth sofrës) - Të gjitha ritualet do të shoqërohen me këngë dasme dhe në fund do të kërcëjë në gjithë në sheshin para skenës. - I ftuar special është aktori dhe regjizori Kolë Kunora i cili do të recitojë në skenë vargje epike dhe lirike. - Për turistët gjatë kohës do të ketë aktivitete paralele ku do të demonstronhet mjelca e bagëtive, pjekja e ferlikut, tunda e mazës me tpi, prezantimi i xhubletës dhe veshjeve tipike të çobanit, e shumë procese të tjera pune që lidhen me aktivitetin e bjeshkatarëve. - Gjatë koncertit organizatorët do të shpërndajnë edhe disa çertifikata vlerësimi dhe mirënjohje për pjesëmarrësit.

PASURIA E VALLEVE KOREOGRAFIKE, KËNGËVE E VESHJEVE: SHPREHJE E IDENTITETIT TONË

(Nata a parë e Festivalit folklorik "I këdojmë lirisë" në Klinë)

Mbrëmë në Klinë, në skenën e hapur të Festivalit "I këdojmë lirisë", u mbajt Nata e Parë. Nis me një këngë të Arjon Gashit kushtuar Mujë Krasniqit, si dhe me disa valle e këngë nga SHKA "Jehona e Dukagjinit". Në skenë dalin me radhë AKV "Anamorava" (Viti), AKV "Selman Kadria" (Istog), grupi i rapsodëve nga Juniku, SHKA "Drita" Shkup, "Zëri i Luginës" Bujanoc, Rapsodi Nazmi Hajdari, "Ilirida" - Shtime, grupi i rapsodëve Han i Elezit, "Përparim Tomqini" - Dibër Peshkopi.

Gjatë paraqitjeve në skenë e jashtë saj, kombinimi i valleve, këngëve dhe veshjeve, krijoi një përvojë të plotë artistike dhe kulturore që e bën edhe këtë natë unike dhe të paharrueshme. Këto elemente së bashku pasqyrojnë identitetin tonë, duke treguar historinë dhe traditat e tij në një mënyrë të gjallë dhe të prekshme.

1. Vallet austriake: risi e Festivalit

Risi e Festivalit, mbrëmë, ishte se për herë të parë paraqitet edhe një grup valltarësh e valltaresh që nuk i takojnë kombit tonë: ishin një grup me valle austriake të Shoqatsë së kostumeve tradicionale TRACHTENVEREIN FLONINGER, që dhanë një varg vallesh dhe u duartrokitën nga publiku. Ata përcollën, përmes valleve, një komunikim të pëlqyeshëm përvojash dhe përjetimesh të përbashkëta. Nuk thuhet më kot, prandaj, që vallet luajnë rolin e një gjuhe të përbashkët që kuptohet nga të gjithë pjesëtarët e kombeve të tjera; duke bartur vlerat e trashëgimisë kulturore, historinë dhe traditat e një populli. Ato janë një mënyrë e gjallë dhe dinamike për ta ruajtur dhe promovuar identitetin kulturor dhe kombëtar. Ishte dëshmi, pra, se as kombet moderne, të zhvilluara, nuk heqin dorë nga traditat e tyre dhe veshjet e tyre tradicionale, por i kultivojnë ato me respekt e kujdes.

2. Veshjet

Larmia e ngjyrave të veshjeve tradicionale, të pasura me detaje që pasqyrojnë historinë, identitetin dhe estetikën e këtyre qyteteve e zonave, të përzgjedhura me kujdes, i dhanë bukuri ambientit, defileve dhe skenës së Festivalit. Ngjyrat e veshjeve tradicionale kanë edhe kuptime simbolike dhe përfaqësojnë elemente të ndryshme kulturore apo natyrore. Për shembull, e kuqja simbolizon gëzimin dhe festën, por edhe nacionalen, ndërsa e bardha simbolizon pastërtinë dhe paqen. Ato manifestuan atmosferë festive dhe çaste rituale. Çdo rajon ka stilin e vet unik të veshjeve tradicionale. Këto dallime pasqyrojnë diversitetin kulturor dhe geografik të kombit tonë.

3. Vallet koreografike

Kjo mbrëmje u dallua me disa valle koreografike, të cilat lidhen ngushtë me ruajtjen dhe shprehjen e traditave kulturore

të kombit tonë dhe përmbajnë elemente që pasqyrojnë historinë, mitologjinë, ritualet dhe jetën e përditshme të njerëzve që i ka në krijuar ato. Vallja koreografike "Baresha" nga AKV "Anamorava" (Viti), solli dinamikë koreografike, një kombin-



im të përsosur elementesh fizike, artistike dhe kulturore që së bashku krijuan një performancë të gjallë dhe të pasur. Lëvizjet, ritmi, energjia, ndërveprimi ndërmjet valltarëve dhe lidhja me muzikën me motive të këngës së njohur të Nexhmie Pagarushës, si dhe veshjet tradicionale të gërshtuara me gjetje tjera artistike, krijuan mbresa të forta, të paharrueshme.

Një këso game të gjerë stilesh, nga ato të butat dhe elegante e deri te ato energjike dhe të fuqishme, u vërejt edhe të grupet tjera koreografike. Pothuajse, secila lëvizje kishte për qëllim të shprehte një ndjenjë ose histori specifike.

Ishte muzika ajo që përcaktonte tempin dhe intensitetin e lëvizjeve: ritmi i valleve, i lidhur ngushtë me atë muzikë që i shoqëronte, krijuan një harmoni të plotë ndërmjet tingujve dhe lëvizjeve. Energjia që krijohej nga grupi i valltarëve, ishte



thelbësore për suksesin e performancës. Kjo energji u përcoll nga shikuesit, duke krijuar një ndjesi të përbashkët gëzimi dhe përjetimi.

Valltarët komunikonin mahnitshëm

me audiencën përmes shprehjeve të fytyrës, lëvizjeve dhe gjestikulimeve. Ky komunikim krijoi një lidhje të drejtpërdrejtë dhe përfshinte shikuesit në historinë "e rrëfyer" përmes valleve, me emocionet që shpreheshin. Koreografitë përfshinin një

strukturë të organizuar me fillimin, kulmin dhe përfundimin. Kjo strukturë krijonte një rrjedhë të natyrshme dhe e bënte performancën të kuptueshme dhe të këndshme për shikuesit. Dinamika e valleve koreografike ishte një bashkim kompleks dhe harmonik i lëvizjeve, muzikës, energjisë dhe elementeve vizuale.

4. Këngët

Ky Festival po e arsyeton praninë e tij që dy dekada e sa, që nga viti 2000. Këngët shqiptare, me të gjitha larmitë e tyre, përbëjnë një pasuri të jashtëzakonshme të kulturës sonë kombëtare.

Nga ana tjetër, vetë motoja, siç e shpjegoi dje Dibran Fylli (Muja i Kl do nte lirisë edhe në luftë), është unik në Kosovë. Ato këngë, edhe të mbrëmjes së parë, janë dëshmi e gjallë e shpirtit të popullit tonë, e vendosmërisë dhe qëndrësës së tij për-

tonë kombëtar. Kësisoj, edhe këngët që u kënduan mbrëmë, sollën po atë jehonë të festivaleve të përparshëm.

Është Këngëtari popullor shqiptar, i vlerësuar sipas këngëve që na i la trashëgim, e që i përcjell hap pas hapi të gjitha ndodhitë, të mëdhatë e të voglat, ato individuale dhe kolektive, dhe në këtë rrjedhë këndoi historinë tonë të lavdishme.

Tashmë edhe grupet e rapsodëve, si dhe ansamblet tjera, sollën rapsodë që e kanë formuar figurën e tyre nëpër dekada, ashtu skundër erdhën edhe breza të rinj që i përcjellin këto tradita. U dëgjua po ajo jehonë e transmetimit të historive të mëdha dhe të vogla, e ngjarjeve kundër pushtimeve të huaja dhe përpjekjeve për liri dhe pavarësi. Në çdo varg të kënduar, ndihet zemërimi kundër armiqve dhe krenaria e një populli që ka luftuar për ta mbrojtur truallin e vet dhe për ta ruajtur identitetin e tij kombëtar.

Një aspekt i rëndësishëm i veprës së këngëtarit popullor është roli i tij në ruajtjen e gjuhës dhe të folmeve e dialekteve tona. Përmes këngëve të tyre, rapsodët nga Kosova, Peshkëpia, Presheva, apo nga viset e ndryshme të Kosovës, ende arrijnë t'i ruajnë të gjalla fjalët dhe shprehjet e vjetra, duke i transmetuar ato brez pas brezi.

Edhe sot rapsodi është një artist që nuk e harroi kurrë misionin e tij për ta ruajtur dhe transmetuar trashëgiminë e tij kombëtare. Përmes këngëve të tij, ai krijoi një lidhje të fortë mes të kaluarës dhe të tashmes, duke na i kujtuar rrënjët tona dhe duke na frymëzuar për të ardhmen. Ai këndoi lëvizjet çlirimtare dhe përpjekjet e pareshtura të të huajve që u vërsulën mbi popullin tonë për ta asgjësuar dhe robëruar përgjithmonë.

Përmes këngëve, këngëtari popullor dokumentoi jo vetëm ngjarjet e mëdha historike, por edhe përpjekjet e pareshtura të të huajve për ta asgjësuar dhe robëruar popullin shqiptar.

Tani, falë zellit të tij për t'i kënduar ngjarjet historike gjatë e gjatë, ne sot njohim njeriun tonë, shpirtin e tij lirisdashës, njeriun e një morali të lartë, që nuk ia dolën ta thejnë as rrebeshet më të tmerrshme historike, shpirtërisht as fizikisht. Në këngët e tij, këngëtari popullor ka portretizuar njeriun shqiptar si një individ të lidhur ngushtë me lirinë dhe të drejtat e tij. Epika popullore historike shqiptare përfaqëson një nga thesaret më të çmuara të kulturës kombëtare. Këto këngë, të krijuara dhe të ruajtura dhe të krijuara në dekadat e fundit, shërbejnë si lapidarë nderi dhe kujtimi për brezat që kanë kaluar, duke mbajtur gjallë historinë dhe traditat tona. Folkloristët e kanë vlerësuar këngën tonë folklorike, jo vetëm për vlerat e saj artistike, por edhe për rolin e saj të rëndësishëm në ruajtjen dhe transmetimin e identitetit kombëtar shqiptar.

Prend BUZHALA, 7 qershor 2024

Çamëria e Kosova

Në kuadër të aktiviteteve të 25 vjetorit të Çlirimit të Kosovës, në Prizren, më datë 5 qershor 2024, në orën 11, në librarinë "Altera" u organizua promovimi i librit "Çamëria dhe Kosova – Genocid pa ndëshkim" i autorit Hyqmet Zane, me orgjinë nga Çamëria që jeton në Elbasan.

Libri në fjalë është një përmbledhje e intervistave që autori u ka marrë banorëve të vjetër të Çamërisë që kishin parë genocidin grek në vendin e tyre, si dhe banorëve të Kosovës që erdhën në Elbasan në kohën e luftës në Kosovë më 1999, që kanë parë me sytë e tyre masakrat serbe ndaj popullatës së paarmatosur dhe të pafajshme.

Është nder i gjithësecilit që e ndejnë edhe pas 25 vjetësh se çfarë genocidi ndodhi në Dardaninë e lashtë nga kriminaliteti i ushtrisë serbe dhe asaj greke në Çamëri 80 vjet më parë.

Hyqmet Zane është autor i disa botimeve :

- * "Kosova dhe Çamëria përmes dëshmime rrënoqetëse" – 2009
- * "Çamëria – Toka pa njerëz, Njerëzit pa tokë" – 2020,
- * "Çamëria dhe Kosova – Genocid pa ndëshkim" – 2021,
- * "Lidhjet e Elbasanit me Çamërinë" – 2023

Hyqmet Zane është me profesion arsimtar, sot i sapo dalë në pension, është aktiv në jetën publike në Shqipëri me kontribute në medha edhe si gazetar në media të shkruara edhe sot e kësaj dite, si dhe kryeredaktor i TV Dardan më vitet 199 –2004. Është një nga pjesëmarrësit në krijimin e Shqoqatës Çamëria në Tiranë dhe drejtues dhe shumë i angazhuar në trajtimin e çështjes çame, si dhe angazhime të tjera me karakter kombëtar.

Prezanti im, për çështjen çame duke shpalosur Platformën për Shqipëri të Bashkuar si organ i LSHB-së, nga autori K. Berishaj.

Çështja çame lindi me vendimin e Konferencës së Londrës më 1913, e cila e shkëputi këtë trevë shqiptare dhe ia dha atë Greqisë. Që nga kjo kohë filloi një presion i vazhdueshëm, një politikë sistematike e shtetit grek dhe e forcave të ndryshme ultranacionaliste për shkombëtarizimin e kësaj treve. Në vitin 1913, bandat e Deli Janaqit, të organizuara dhe të përkrahura nga qeveria greke, masakruan dhe vranë te Përroi i Selanit, në Paramithi, 72 burra nga krerët e kësaj krahine.

Ky ka qenë fillimi i shfarosjes së shqiptarëve të Çamërisë.

Në vitet 1914-1921, nën pretekstin e çaromatimit të popullsisë shqiptare të Çamërisë nga qeveritarët grekë, u kryen ndjekje, persekutime, tortura dhe grabitje ndaj popullatës. Për këtë qëllim u përdorën të gjitha mënyrat, si tatimet e rënda, grabitja e tokës, përjashtimi i popullsisë nga pjesëmarrja në administratën shtetërore, ndalimi i dhunshëm i arsimit në gjuhën amtare, madje edhe në shkollat fillore, vrasjet, burgimet, dënimi me dhunë deri në masakrat e përgjakshme.

Masakrat dhe plaçkitjet barbare greke,

ndaj Çamëve në trojet e tyre, ka ndodhur jo vetëm gjatë Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, por gjatë gjithë shekullit, duke përfshirë Luftën e Dytë Botërore dhe më pas. Nën regjimin e Metaksait (1936-1941), Çamët ishin të ndaluar të përdorin gjuhën e tyre jashtë shtëpisë dhe propaganda fetare dhe anti-shqiptare ishin në fuqi të plotë.

Gjatë kësaj kohe nënshkruhet marrëveshja greko-turke për shkëmbimin e popullatës muslimane çame dhe popullatës greke, një pjesë e popullatës çame dërgohet në Turqi dhe popullata greke nga Turqia vendoset në pronat çame dhe nga këtu fillon ndryshimi i strukture etnike në Çamëri.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Çamët u

persekutuan në "hakmarrje", për bashkëpunimin e tyre të dyshuar, me fuqitë e Boshtit. Si pasojë e Luftës së Dytë Botërore, persekutimi i vazhdueshëm i Çamëve ka detyruar shumicën e tyre për të ikur në Shqipëri, Turqi, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata që mbetën u përballën me praktikatat të rënda asimiluese.

Çështja Çame është e regjistruar në dokumentet e Lidhjes së Kombeve, Misionit Britanik Ushtarak, si dhe misione të tjera të ndryshme diplomatike që nga 1913 në 1940 dhe më pas. Historian dhe gazetar, Z. Noel Robert Malcolm thotë, "Fati i shqiptarëve të Çamërisë është një nga sekretet më të errëta të historisë moderne Europiane".

Sipas dokumentave të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, Nr.84/3, të Misionit të Tiranës 1945-46, shkruhet: "Në bazë të gjithë informatave që kam mundur të mbledh mbi Çështjen Çame, në 1944 dhe muajt e parë të 1945, autoritetet në Greqinë perëndimore, kryen masakra brutale duke dëbuar me dhunë më shumë se 25.000 Çamë, banorë të Çamërisë nga shtëpitë e tyre ku kishin jetuar me shekuj dhe i nxorrën jashtë kufirit, mbasi u kishin rrëmbyer tokat dhe pasuritë. Shumica prej atyre të vrarë ishin fëmijë dhe pleq".



Gjenerali famëkeq grek Napoleon Zervas e shkruan me dorën e tij të gjakosur, në letrën që i dërgon më 1953 një ish bashkëpunatori të tij, Jani Danit: "Duhet të ndihemi krenarë se pastruam Çamërinë duke vrarë e dëbuar shqiptarët, të cilët për mbi 500 vjetë qëndruan mbi qafë të helezimit dhe ju mundësuan malësorëve tanë të zbrasin e të jetojnë në fushat pjellore."

Edhe sot e kësaj dite, në trojet e Çamërisë vërehen gjurmët e krimit, pronat që i presin pronarët që të kthehen, toka e gjakosur me gjakun e fëmijve, grave shtatzënë, pleqve e plakave, që me shekuj i mbijetuan robërisë dhe shfarosjes shtetërore të pushtesit.

Çamëria duhet të trajtohet me një status të veçantë, e neutral ndaj Greqisë si protektorat ndërkombëtar (3 deri 5 vjeçar maksimum), përmes së cilit do të garantohet:

- Rikthimi i popullsisë shqiptare në Çamëri
 - Njohja e shtetësisë së dyfishtë
 - Rikthimi i pronave
 - Kompensimi për përdorimin e pronave
 - Njohja e genocidit ndaj çamëve
 - Organizimi i pushtetit dhe administratës në gjuhën shqipe, si gjuhë zyrtare
 - Hapja dhe financimi i shkollimit në gjuhën shqipe, të të gjitha niveleve, dhe parapërgatitja e terrenit për statusin përfundimtar, mbi parimet e vetëvendosjes dhe të drejtës për dekolonizim.
 - Shteti i përbashkët shqiptar, përmes Fondit për Zonat e
- Rezikuara duhet të stimulojë rikthimin në identitet dhe orgjinë të shqiptarëve ortodoksë në Çamëri, të cilët janë të shumtë në trevën e Prevezës dhe Filatit.

FRASHËR RACAJ



POEZIA E ALI PODRIMJES - MELODIA MISTIKE E JETËS SË TIJ

Arti i pikturës disa shekuj me parë ishte pasqyrë e nivelit intelektual dhe shijeve artistike të kohës por me zhvillimet shoqërore të Rilindjes Evropiane teatri dhe pastaj poezia morën një lulëzim cilësor. Persekutimi gjuhësor otoman ka bërë që poezia e vërtet shqipe të zgjohet me vonesë. Fillimisht rilindësit tanë, duke botuar jashtë vendit dhe pastaj një revoltë etnike kombëtare bëri që vjershat dhe poezia të fitojnë terren dhe të kultivojnë atdheadashuri në popull. Këtu nisi një epoke, kur fjala e poetit dhe fjala e shkruar ndikoi në jetën e përditshme të shtresës së shkolluar. Ky rol është arritur sidomos përmes instinktit të lirisë dhe polemikave shoqërore ku si shembull madhështor tek ne mbetet Fishta

Në këtë trend shoqërore përfshihen shkrimtarë, gazetarë, artistë dhe politikanë, që zgjonin interesim dhe kanë ndikim në zhvillimet shoqërore politike të vendit. Por edhe polemika idesh që nuk qëndronin vetëm në rrethin letrar dhe përfshinin aspekte të ndryshme të jetës politike dhe shoqërore. Në pemën e madhe të artit poetic, poezia është në degat afër livadhit popullor, më e para dhe më e thjeshta për tu konsumuar.


Nëse Shqipëria e krijoj elitën poetike pak më herët, Kosova në fushën e poezisë vjen një hap me vonë. Një figurë intelektuale e mirëfilltë dhe e rrallë në këtë aspekt është poeti Ali Podrimja. Në rastin e tij mundemi me than se është një talent i lindur

Ai, nuk njihet vetëm si njëri nga poetët më frytdhënës të letërsisë sonë bashkëkohore, por arriti të shndërrohet në zëdhënësin besnik të vendit të tij, duke zgjidhur në mënyrë origjinale raportin historik me ndjenjën jetësore dhe shpresën për ndryshim. Vargu i tij u rrit pa e hequr vëmendjen nga modelet folklorike, mitologjike të popullit shqiptar. Ali Podrimja përfaqëson figurën e intelektualit të angazhuar në shoqëri dhe arti i tij e pasqyron këtë mjaft qartë. Poezia e tij, vargjet e tij janë konkrete dhe jetësore, konceptet jetë dhe poezi janë sinonime.

Podrimja ishte një poet i kursyer në fjalë, i papërsëritur në sintaksën poetike, një poet me shpirt të trazuar, gjithnjë në kërkim të mjeteve të reja të shprehjes artistike, përmes një gjuhe provokuese.

Poezinë e tij e karakterizon një gamë e gjerë e problematikës dhe një shumëllojshmëri e mjeteve shprehëse. Podrimja është poet i revoltës dhe i rezistencës, gjithnjë në luftë me të keqen, me mizorinë, barbarinë dhe më në fund në luftë me sëmundjen, vdekjen. Ai solli në poezinë moderne shqipe një ndjeshmëri dhe intonacion të ri poetik. Podrimja nuk kopjoj askund ai ishte vetvetja, ai ishte poezia Kosovare në telajo dhe në pentagram poetik ..

“Te kishim lindur në një kohe tjetër / Urithi s’do ta gërryente Drinin / Do t’isha i lis i drejte n’ diell / mbi vetull e molle në shtize. / Tani i thyej dhembët me kurrkushin / e pres të hapet Qielli i Verdhe. / Nuk ta di



as varrin miku im / Bie këndeje apo andej Murit të Arbrit.”

Në veprat e tij poeti kemi jo vetëm probleme të ekzistencës kombëtare, të etnisë dhe të atdheut, të realitetit të hidhur të kohës, po ai shtron probleme universale të ekzistencës njerëzore të rëndësishme në luftën e individit përballë sistemeve totalitare, për liri dhe demokraci, të individit të mbërthyer me trauma e krizat e kohës, po edhe i shkatërrimeve më të mëdha njerëzore, për të cilat dëshmon historia. Studiuesit e poezisë së tij theksojnë se ai nuk pushoi së shkruari edhe atëherë kur “Kohët e egra trokitën pullazeve tona gërmuqe” dhe kur “Buzëqeshja u mbyll në kafaz”.

“Dodona”, “Ura e Shenjtë”, “Molla e Kuqe”, “Guri i Prevezës”, “Janina”, “Tomori”, “Pashtriku”, “Korça”, “Ohria”, “Joni” e të tjera., ishin toponime të shpeshta të poetikës së tij.

Ali Podrimja si poet do të mbahet mend si njeri që krijoi një libër të rrallë me poezi në gjuhën shqipe, vëllimin poetik “Lum Lumi”, të botuar për herë të parë në vitin 1982 në Prishtinë dhe të ribotuar shumë herë të tjera më vonë, të përkthyer edhe në shumë gjuhë të tjera të botës, posaçërisht të Ballkanit dhe Evropës,

Podrimja me plot të drejtë konsiderohet, një ndër poetët më të mirë shqiptarë dhe më përfaqësues në botë. Poezia e tij është dëshmi e një vetëdijesimi kolektiv në luftën për liri e pavarësi në Kosovën e gjysmës te dyte te shekullit kaluar ku poezia e tij u bë zë i përgjithshëm i popullit.

“Unë, biri yt, Kosovë t’i njoh dëshirat e heshtura, / t’i njoh ëndrrat, erërat e fjetura me shekuj, / t’i njoh vuajtjet, gëzimet, vdekjet, / t’i njoh lindjet e bardha, caqet e toka të kulluara; / ta di gjakun që të vlon në gji,”

Ali Podrimja, njëheri të njihet edhe për gjuhën metaforike, e eksperimentale, që në përmbajtje ka urtitë e kulturës go-

jore. E gjithë poezia e tij, merr shembuj anekdotike e përrallorë, të shoqëruara me karakterin historik të origjinës së hershme të shqiptarëve që nga ilirët deri në ditët e sotme. Ai ka një sistem të të folurit ku urtitë dhe proverbat, krijojnë një lirizëm epik

“Medet, kë më parë të shpëtoj: veten apo zogjtë e ngrirë n’ ajër?! / Nipave ç’ tu them për këngën time të vdekjes? / – Heu, edhe kryet po të ma hiqni, tjetra do t’ më kish mbire!”

Ai i takon atij brezi të poetëve të formuar në vitet ’60, për të cilët poezia ishte jo vetëm shprehje intime, por edhe pasqyrë e përparimit dhe formimit intelektual. Padyshim këndvështrimi poetik i Podrimjes na mundëson interpretime dhe lexime të ndryshme, por do të ndalem kryesisht tek koncepti “poet i frymruar nga jeta”. Ketë indicje më jep vepra e tij në total, jo vetëm si nocion artistik, por edhe veprimtaria letrare e publicistike.

Cili është sipas Podrimjes intelektualit i vërtet, që i duhej kohës?! Podrimja jo vetëm u angazhua për fatin e shoqërisë në të cilën jetoi, por ai luftoi vijimisht, që të mos mbizotëronin antivlerat dhe totalitarizmi. Ai i përgjigjet dhe promovon potretin e intelektualit bashkëkohor. “Në epokën e mbi-komunikimeve, njeriu i veprimt, aktivisti, intelektualit i angazhuar shndërrohet në njeri ose Mbi-njeri i komunikimit, Herkul medias”. Podrimja cilësohej para së gjithash nga shpirti i pastër i revoltës dhe e ndjente fort përgjegjësinë dhe rolin e intelektualit përpara shndërrimeve të vrullshme, apo delikate të shoqërisë.

Duke jetuar fazat e pasluftës së ish-Jugosllavisë, duke përfshirë edhe krizën ideologjike, që Kosova e tij kaloi për të mbërritur në statusin e saj të pavarur, Podrimja dëshmoi se cili duhet të ishte verbër, ne tunelin pa drite, mjafton të

ndez vetëm një llambë .

Ajo çka e veçon mbi të gjitha fjalën e Podrimjes - Poet është se ai e ka mjaft të qartë hapësirën imagjinare të krijesës poetike, dhe angazhimi për këtë çështje nënkupton veprim dhe mendim. Ai e shtjellon mendimin para së gjithash në një kohë mitike, me vlera të padiskutueshme. Podrimja na ofron një model të qartë etik që të kujton Aristotelin, por edhe një model të qartë moral si Hegeli, i ndërgjeshëm se njerëzit dështojnë nga ana morale, ndërsa institucionet nga ana etike.

Poeti e vuan këtë krizë vlerash dhe shpesh i drejtohet hapësirave mitike. Për shkak të dashurisë, për shkak të urrejtjes

“Baba im ka ngritur një kullë / Në majë të botës e ka ngritur / deri në tokë e kanë rrënuar zotat...”

Koncepti i tij poetik lëviz dhe vendoset në vendin e shumë përvojave njerëzore. Mua me jep idenë se poezia e tij është një melodi e trishtë e kohës kur ai jetoj, Plagët e shpirtit Dardan nuk i pasqyron dot një kronike e cinguar e kohës të censurës. Poezia ishte një telajo e madhe që do ju lihej brezave. Të shumta janë mitet që hasim në poezinë e Podrimjes, por më të përdorurit është miti i flijimit dhe miti i qëndresës

“Tërë jetën çela varre / Dhe ngrita kulla, Majë ëndrrash”

Për Podrimjen poezia është guri i themelit në kullën poetike të atdheut, që ka ditur t’i mbijetojë historisë dhe kohës. Kjo nënkupton gjithashtu edhe vetëdijen e hidhur se lufta për mbijetesë nuk çon në proces ndërtimi dhe progresi, sepse siç na kujton Migjeni, ku plaga ndërgjegjes vret, murrilani i fuqisë ka shter, liria nuk asht as në hije! Poezia e Podrimjes shpesh merr tone sarkazme kundër aftësisë së shqiptarit, që nuk arrin të ndërtojë dhe të anashkalojë ndarjet, duke u lëkundur në politika përshtatjeje dhe statike,

“ si dele nuk dilet në pazar, apo na shurdhohet i pagoji / me rrënjë ia shkulum / e bëjmë gjumë të rehatshëm / mes gjinjve të një rospie.”

Podrimja, kur shprehet mbi dukuritë shoqërore, dëshmon përgjegjësi të madhe dhe ndjeshmëri të mprehtë; kujtesa e tij nuk është vetëm personale, por e ndërtuar nga një kujtesë historike në funksion të popullit, duke arkivuar data, emra, vende, ngjarje që kanë përshkuar dhe kanë ndikuar në procesin historik mbarëshqiptar. Poezia e Podrimjes funksionon si mozaik gjeografik, në të cilin përveç referimeve të vendeve dhe të personazheve të Kosovës, gjejmë edhe vende dhe personazhe të tjerë, që kanë të bëjnë me Shqipërinë, Çamërinë dhe fshatrat arbëreshe.

E ashtuquajtura lirikë patriotike, element karakterizues i shumë shkrimtarëve shqiptarë, tek Podrimja është e pranishme

në mënyrë origjinale.

Kritika e shoqërisë shqiptare, zhgënjimi dhe pikëllimi për qytetërimin “e cunguar” paraqiten nëpërmjet tablove poetike në të cilat e shkuara dhe e tashmja ndërlihen dhe vihen në dyshim në të njëjtën masë.

Një varg imazhesh fosforeshente lëvizin brenda kornizave të kësaj “fotografie të grisur” poetike të poetit Feniks të hapësirës mbarëshqiptare.

Të paraqesësh mirëfilli marrëdhënien midis së shkuarës dhe së tashmes do të thotë të trajtosh konflikte të pashmangshme dhe si rrjedhim të jesh pre e kundërshtive të këndvështrimeve estetike dhe ideologjike. Ndoshta ka ardhur koha, siç braktisim idenë e artit larg jetës së përditshme, si përvojë e jashtëzakonshme dhe ta konsiderojmë si formë pasurimi, intensifikimi dhe zgjerimi të përvojës njerëzore... Kjo marrëdhënie nënkupton edhe kthimin pas të disa zgjedhjeve poetike, si shprehje stilistike dhe formale, si strategji për të folur mbi botën që e rrethon dhe për të vendosur dhe përligjur rolin e tij si poet. Kjo shije paraprake ka të bëjë mbi të gjitha me evolucionin stilistik të Podrimjes, i cili, depërton në “arkivin mitologjik” të kulturës për të vënë në pah ato vlera, që i mungojnë të tashmes.

Nëse teoria e telepatisë të Frojdit ka një shpjegim konkret është ky poet, nëse donë të argumentosh se vërtet krijuesit janë një hap përpara zhvillimeve shoqërore dhe njerëzore lexo krijuesit e gjeniut të poezisë Dardane

Ali Podrimja, mund të thuhet se e parandjeu (profetizoj) fundin e jetës së vet në vargje e poezisë Vdekja e poetit Ali Podrimja ishte një mister, që dhe habiti të gjithë miqtë, të afërmit, njohësit e poezisë së tij, por edhe më gjerë.

Ashtu si vargjet që shkroi gjithë jetën, të cilat mbulohen nga mjegullnaja simbolike, gjuha enigmatike, ashtu përfundoi edhe jeta e këtij gjeniu te poezisë shqipe, në një vorbull paqartësie, në mënyrë të beftë dhe mes pafundësisë së shtigjeve të të panjohurës.

Poezia ishte lajtmotivi i jetës së tij, ishte zëri dhe tik-taku i shpirtit të tij, që

u ndal pikërisht në një nga tubimet poetike të kryeqendrës kulturore evropiane, Francës. Çuditërisht trupi i tij u gjend pranë një pylli, jo në dhomën e ndonjë spitali apo hoteli, por në mes të natyrës dhe të gjithësisë, e konkretisht mu pranë një lumi.

A thua Lumi e thërriste, sepse ai gjithë jetën kishe shkruar për të dhe kurrë nuk guxoi ta pranojë vdekjen e birit të tij të dashur (Lumit), sepse e ndjente thellë brenda qenies frymëmarrjen e tij, e shihte gjithkund.

“vdekjen tënde nuk mund ta nënshkruaj vogëlush / varrëmihësit le ta qesin emrin / ose bardhësia le të më mbulojë edhe mua të tërin / Nga poezia “Fletë e bardhë”, shkruar në Ulpianë, në tetor të vitit 1982”

Pavarësisht tragjizmit që mbarte vdekja në lulen e rinisë e Lum Podrimjes, autori arriti që ta universalizonte dhimbjen dhe trishtimin e tij, duke përcjellë në të, jo vetëm fatin e birit të vet, por fatin e mijëra shqiptarëve të rënë për atdheun dhe gjithashtu fatin e miliona njerëzve që kanë humbur jetën dhe vijojnë të shuhën nga kjo botë, në përpjekje për të kërkuar lirinë dhe të drejtat që u takojnë.

Shtresëzimet motivore nga ai personal tek ai kombëtar dhe deri tek motivi universal janë të pranishme në të gjitha poezitë e kryeveprës lirike të letërsisë shqipe “Lum lumi”, vepër e botuar pesë herë dhe ku në të pesta botimet ka ripunime dhe rimodelime të vargjeve.

Secili variant i vëllimit poetik “Lum lumi” ka specifikat e veta si në aspektin formal, ashtu edhe në atë përmbajtjesor. Këto pesë variante të “Lum lumit” dëshmojnë kujdesin për figurën e lumit, frymëzimin dhe gjithë opusin poetik të Ali Podrimjes. Duket sikur vetë “lumi” si element i natyrës dhe si personifikim i një qenie njerëzore të identifikuar me këtë emër, është simbol personal i poetit tonë të pavdekshëm. Ndryshe nga shumë autorë të tjerë, ku simboli i lumit vërvitet pak a shumë rreth të njëjtës fushë semantike, duke simbolizuar vitalitetin, vi-

jimësinë, lëvizjen e përhershme e të tjera, tek Ali Podrimja elementi i lumit priret të nënkuptojë ngjyresa kuptimore personale dhe krejtësisht autentike nga ana e autorit. Më shumë sesa jetën, lumi shënjon vdekjen dhe më shumë sesa lëvizjen e freskinë, ky simbol shënjon thatësinë e mungesën e çdo gjurme jetësorë :

“Në bregun tim nuk dukesh / as nuk të lag më / valë e lumit tim / Sorra të dergjura grimcojnë / ëndrrën

dhe myshku ha emrin në gurë. / (Poezia “Myshku, emri”)

Thuhet se poetët u përngajnë profetëve që parathënë fatet e njerëzve, e në këtë pikëpamje duket sikur edhe Ali Podrimja parandjeu në vargje ëndrrat e popullit të vet, por edhe profetizoi të ardhmen dhe fundin e jetës së tij fizike. Ky perceptim shihet në dy përbërës, që janë dominues në poezinë e tij: - Lumi dhe vdekja. Kjo ide spikat më tepër në poezitë: Vdekja ishte më e shpejtë se unë”, “E ti i vdekur”, “Pikëllime”, “Unë nuk jam ai” .

Në të gjitha këto poezi si për çudi, rasti apo telepati simboli i lumit lidhet herë në mënyrë të drejtpërdrejtë, e herë të tërthortë me vdekjen.

Kemi një poezi që duket sikur flet me vdekjen e parandiere “Parisi, vendlindja” në të cilën heroi lirik, që në këtë rast përfaqëson vetë autorin, hyn në Paris bashkë me Lumin, për të ngulur gurin e fundit të ekzistencës së tyre:

“Do të hyjmë në Paris / gurin tonë aty do ta ngulim, / nuk do të na presë Teuta, Genti / nuk do të na presë hordhi e egër romake / nuk do të na presë njeri i gjallë..”

Këto fakte rastësore duket sikur poeti i ka parathënë vazhdueshëm në vargjet e tij. Poeti dha shpirt në Francë, pikërisht aty ku më shumë se 40 vjet më parë do të jepte shpirt biri i tij Lumi teksa kurohej për sëmundjen e rëndë të kancerit.

Mistikë, mitike, tragjikomike, apo hyjnore poetike si vetë fantazia e tij krijuese. Poezia e Ali Podrimjes ka vlera universale dhe është pjesë e fondit të artë të poezisë moderne bashkëkohore

mbarëbotërore. Për vlerat e krijimtarisë së tij në letërsi flasin botimet e poezive të Podrimjes në rreth 40 gjuhë të botës dhe qindra e mijëra artikuj studimorë të botuar nga studiuesit më të njohur shqiptarë dhe të huaj. Ali Podrimja është nderuar për së gjalli me titujt më të lartë letrar, ku vlen të përmendim shpërblimin e mirënjohur letrar “Nikolas Linau”, në Shtutgart, të cilin e mori në Gjermani, në vitin 1998, më tej në vitin 2005 u vlerësua me çmimin ndërkombëtar të poezisë “Liburna”,

Jo vetëm kaq, në vitin 2006 Podrimja renditet mes 400 poetëve më të mirë të Evropës, sepse poezitë e tij publikohen në revistën ndërkombëtare italiane “Poezia”, me poetët e shekullit

Poeti dhe akademiku Ali Podrimja do të kujtohet gjithnjë jo vetëm për krijimtarinë që la pas, por edhe për vlerat e larta njerëzore, që shpërfaqte. Vdekja e tij mistike dhe simbolike, njëlloj si jeta dhe poezia që la pas Dua ta mbyll me disa vargje paqe dhe shprese, me një mesazh që mundemi ta lexojmë në çdo mikro dhe makro të jetës tonë si komb.

Koha është të duhemi, / të kesh besim në mua kur të them: Trime, / të kem besim në ty kur më thua: Trim. / Për kokën time kryeneçe shumë kurthe ngrite, / shumë e pushkët mbushi babai yt, fisi yt, / një mijë e një të zeza kurdise ku do t’ma zije pritën. “

“Është koha të duhemi., nga A. Podrimja!

Nuk kam menduar ndonjëherë se do të bej një analizë për melodinë poetike të Podrimjes, kur këndvështrimi im studimorë do të mbetet si dokument, por do të shkoj tek lexuesi nëpërmjet Revistës letrare “Metafora”, më bëri ta njoh më mirë këtë poet, që erdhi dhe iku si Feniks. Tani e njoh më mirë Kosovën, me çizmen sllave mbi kurriz, tani e vlerësoj më shume jetën e dëshmoreve; tani e dua më shume Podrimjen.

Lulash Brigja - Shkodër 2024

Universi paralel i Zija Çelës

Shkrimtari Zija Çela me romanet e tij të njëpasnjëshme të botuara në këto vite, ngjan me një personalitet që e ka zënë gjithë hapësirën e tij krijuese, korpusi i tij letrar shfaqet aq i përplotësuar, sa nuk mund të shtosh e as mund të heqësh gjë prej gjëje. E megjithatë, me Zija Çelën ngjet si me hapësirën që zgjerohet; hapësira e tij krijuese zgjerohet nga romani në roman, sa fundi i romanit të sapobotuar ngjan sikur mbjell farën e një romani të ri. Dhe në këtë hapësirë krijuese që zgjerohet, secili roman pasardhës është më gjithëpërfshirës, më total. I tillë është edhe “Djali Komik”; një roman total, gjithëpërfshirës.

Milan Kundera në esenë e tij të gjatë “Arti i Romanit” shkruan: “Romani është një meditim për ekzistencën siç shihet ajo nëpërmjet mediumit të karaktereve imagjinare”. Zija Çela me imagjinatën e tij magjepsëse dhe me energjinë e tij të pashtershme krijuese pikërisht këtë ka

arritur: të shkruajë një roman tronditës për ekzistencën tonë të mbushur me pasiguri, absurd, tragjizëm, ku jetët dhe fatet njerëzore luhen në një skenë groteske, herë-herë qesharake. Si edhe në romanet e mëparshme, në procesin e tij letrar, Zija Çela krijon një univers paralel me universin në të cilin jetojmë, një univers që është vetëm i tij, ku shkrimtari gëzon lirinë e tij të pakufizuar nga modelet, traditat e shkollat letrare, ashtu si nga imponimet që ushtron realiteti mbytës dhe historia me dëshmitë e saj kokëforta, të patjetërsueshme.

Në këtë univers krijues e paralel me tonin, Zija Çela është i gjithi vetvetja në nivelin më të lartë të shfaqjes, në formën më të lartë të ekzistencës, atë të demiurgut, krijuesit. Kur kam shkruar për romanin e tij “Ora e Zooparkut”, kam thënë se Zija Çela nuk është një shkrimtar që ne thjeshtë e lexojmë, ai është shkrimtar që gjithashtu e lexon njeriun, na lexon thellë ne lexuesve të tij. Në “Djali Komik” shkrimtari ndjek një procedurë tjetër. Ai vë në objektivin e syrit të tij shoqërinë

shqiptare, por edhe shoqërinë njerëzore në tërësi, ashtu sikurse një mikrobiolog vë në objektivin e mikroskopit një koloni bakteresh dhe e vëzhgon.

Zija Çela i deshifron vëzhgimet e tij dhe i përshkruan me një gjuhë drithëruese, ku spikasin gjithashtu hapësira e imagjinatës dhe stili mjeshtror i rrëfimit. Kolonia njerëzore në romanin “Djali Komik” është një koloni e vështruar me një sy pa perde, me një sy depërtues, që sheh thellë e më thellë në qenien tonë individuale dhe në organizimin tonë social e shtetëror, zbulon raportet ngjethëse të individëve, në të shumtën e herës të degraduara, të molepsuara nga mungesa e idealit, bjerrja e virtytit dhe shthurja, raporte të dekompozuar deri në një shkallë të frikshme, aq sa të vjen të ulërisht: këta jemi ne, kjo është shoqëria në të cilën jetojmë, kjo është bota groteske në të cilën ekzistojmë.

Universi paralel i Zija Çelës, edhe pse fiction i pastër, është në të njëjtën kohë universi ynë dramatik e komik, veçse shkrimtari me aftësinë e tij arrin të na çlirojë disi nga verbëria kolektive. Është

zakon që në shkrimet për librat të flitet për subjektin, karakteret, të argumentohet se përse ky roman duhet lexuar. Dhe nuk është zakon i keq. Por në rastin e Zija Çelës, kjo është e tepërt.

Sepse Zija Çela nuk të zhgënjën në asnjërin nga krijimet e tij, qofshin tregime të shkurtë prej disa faqesh, apo romane qindra faqesh. Mjafton të lexosh disa paragrafë për të kuptuar se sa madhështore e magjepsëse është gjuha e shkruar, se çfarë bukurie tronditëse dhe imponuese bart në vetvete fjala, sa urtësi dhe dije universale ruhet në kodet e saj. Fjalët në penën e Zija Çelës jo vetëm krijojnë me perfeksion një univers paralel, por edhe na bëjnë të jetojmë e të ndihemi të shpëtuar brenda këtij universi. “Romanet janë për njerëzit e tjerë, kurse poezitë shkruhen për vetveten”, – thoshte poeti amerikan Filip Larkin. Duke çmontuar metaforikisht strukturën e jetës së vet, Zija Çela projektonte dhe ndërton krijimet e tij për ne, njerëzit e tjerë, lexuesit e tij, për çka i jemi thellësisht mirënjohës.

Shkrimtari LAZER STANI

NË KUJTIM TË HEROIT TË POPULLIT TOMË KOLA

Dukagjini ka nxjerrë shumë figura të ndritura në të gjitha fushat e jetës në art, sport, kulturë, patriot e atdhetar, që kanë marrë pjesë në momentet më kulmore të historisë. Për promovimin e vlerave të tyre janë shkruar shumë libra nga autor dukagjinasi sidomos tre dekadat e fundit, duke i përmendur me emër shumica e tyre kanë shumë vlera, por edhe ndonjë që s'ua patëm dëgjuar më parë emrat as bëmat e tyre. Janë shkruar shumë tekste këngësh e interpretuar cilësisht nga këngëtar dukagjinasi, duke e pasuruar trashëgiminë kulturore të Dukagjinit, duke i përmendur me qindra emra varg e vijë me shumë vlera, por ndonjë edhe pa vlerë e të pa dëgjuar më parë.

Më ka bërë shumë përshtypje, që pothuajse në të gjitha krijimtaritë apo veprimtaritë e zhvilluara nga dukagjinasi nuk është shkruar asnjë rresht apo fjalë për një ndër bijtë më të lavdishëm të Dukagjinit e Shkodrës – Heroin e Popullit, Tomë Kola. Edhe ndonjë veprimtari, që bën Komiteti i veteranëve janë shumë të vaktë me fare pak njerëz dhe arrijnë deri aty sa nuk ftohen as të afërmit e heroit. Edhe shkollës 9 vjeçare Prekal, ju hoq emri i tij sapo demokratikasit morën pushtetin në Postrrib, duke e lënë fare pa emër. Kanë mbetur me emrin e tij një lagje e një rrugë në Shkodër dhe një lapidar në gjen-dje mjerinë në fshatin Domen. Mbi të është aplikuar "lufta e klasave" e kohës së sotme. Çfarë duhet të bëjnë më shumë një njeri për atdheun e vet sesa me dhanë jetën në lulen e rinisë, në mënyrë që të kujtohet, duke u bërë i pavdekshëm? Prandaj mendova ta shkundi sado pak nga pluhuri i harrësës këtë figurë të lavdishme të Dukagjinit e Shkodrës. Këtë e bëj më tepër për brezin e ri, i cili nuk po është sa duhet i etur për dije, nuk po bëjnë sa duhet asnjë përpjekje për të njohur historinë, por janë të dhëna mbas tik-tokut, fejsbukut e rubrikave në media, që për gjithçka mund të ndikojnë, por vetëm edukim nuk të bëjnë. Kësaj ane negative të brezit të ri po i shërben edhe shkolla, me punën e saj të dobët në drejtim të edukimit, që as tekstet e ripërpunura nuk të edukojnë. Në brezi i tretë kemi mësuar shumë për heroin Tomë Kola dhe ata që nuk i ka lënë kujtesa dinë edhe sot shumë për të. E kujtoj, kur në hapat e para të shkollimit kemi mësuar edhe këngë për Tomë Kolën, që njëra ndër të kishte këto vargje:

*Trimi azgan
shoku Tome Kola namin po e ban
rreptë mbi milic
qëllon me nishan
me pushkën e tradhtarit
e pranë atë farë djali
për ty Nënë Shqipëri*

Kush ishte Tomë Kola?
U lind në fshatin Prekal, me 21 qershor

1921, në një familje, me tradita patriotike e atdhetare, shumë bujare dhe e prirur veç me bë mirë, me prindër Zef Kolën dhe Lenë Prëken nga Tebregu i Planit, katër vëllezërit e së cilës ranë heroikisht në luftën kundër malazezve në korrik të vitit 1915, duke mos lënë mashkull në vatër.

Pra, Toma e ka pas në gen heroizmin për atdhe. Në moshë shumë të re mbetet jetim nga i jati dhe përballimi i jetesës ishte e vështirë, sepse mbretëronte një varfëri e tejskajshme. Kështu, që në vitin 1928, me ndihmën edhe të kishës, shkollës



në Shkodër dhe pranohet në jetimorën e qytetit. Gjashtë vjet më vonë pranohet në konviktin "Malet Tona", i cili më vonë mori emrin e tij dhe regjistrohet në vitin e parë të gjimnazit të shtetit.

Toma ishte nxënës shumë i zgjuar e inteligjent. Në shkollë u edukua me ndjenja të forta revolucionare e patriotike nga kontaktet, që pati me Vojo Kushin, Emin Durakun, Hajdar Dushin, Sadik Bekteshin e të tjerë nxënës të gjimnazit të Shkodrës. Si shumë të rinjë, edhe Toma pushtimin fashist e priti me urrejtje. Në demonstratën antifashiste të 28 nëntorit 1939 Toma ishte një ndër organizatorët e saj. Drejtorja e shkollës, duke u nisur nga ky fakt e përjashtoi një muaj nga shkolla, kurse Ministria e Arsimit e thelloj këtë vendim, duke e përjashtuar për një vit nga të gjitha shkollat e Shqipërisë. Fashistët i arrestuan organizatorët dhe i internuan në ishullin Ventetemo të Italisë, duke i dënuar me dy vjet internim.

Në verën e vitit 1941, Tomën e shokët e tij i kapi amnistia dhe u kthyen në atdhe. Në Shkodër lidhet me Perlat Rexhepin dhe e sistemoj në punë pranë zyrës së punëve botore, në të cilën ai, ishte teknik. Me formimin e Partisë komuniste ai, ishte ndër dyqind anëtarët e parë të saj.

Në shkurt të vitit 1942 Toma zgjidhet anëtar i të parit Komitet Qarkor i Rinisë

Shqiptare. Aty, Toma u takua me shokun e shkollës Qemal Stafën dhe merr pjesë aktive në demonstratën e madhe antifashiste të 28 nëntorit 1942, në të cilën edhe u plagos. Nën kujdesin e shokëve e sidomos të familjes Kapeszyzi, Toma u ruajt nga armiku fashist dhe u mjekua në ilegalitet.

Në pranverën e vitit 1942, Toma doli partizan në çetën e Postrribës, në çetën e parë partizane. Më pas, me krijimin e çetës Pukë – Mirditë së bashku me Bardhok Bibën, Naim Gjylbegun e Fahri Ramadanin, u rreshtua në radhët e saj.

Mbas disa kohësh Toma u kthye përsëri në çetën e Postrribës. Ishte njeri i aksionit dhe kishte aftësi të rralla organizative. Me 19 prill 1943, pjesëtarët e njësitit partizan të Urës së Shtrenjte, bijën në rrethimin e mbi njëqind mercenarëve fashist në fshatin Domen. Pas dy orë luftimesh të ashpra, partizanët të pakët në numër u tërhoqën në bjeshkët e Domnit. Tërheqjen e tyre e mbuloj me shumë vendosmëri Tomë Kola si më i shkathëti e energjiku. Pikërisht në këto momente, Toma goditet nga një plumb i armikut dhe ra heroikisht, duke siguruar pavdekësinë.

Toma, është dëshmorë i parë i qarkut të Shkodrës, që bije në luftë me fashistët. Është ndër të parët shqiptar që është shpallur "Hero i Popullit". Familja humbi njeriun e tyre të dashur dhe çeta partizane anëtarin e saj më të devotshëm. Por kalvari i fatkeqësive nuk mbaron me aq, mbas disa orësh i vdekur në bjeshkët e Domnit, urashtëritësit e ulin në Urë të Shtrenjtë falë guximit e heroizmit të tyre dhe bashkë me prekalorët e transportojnë në Prekal për ta varros.

Prifti i fshatit, një fashist e antinjerëzor nuk lejon ta varrosin në varrezat e fshatit, gjoja si komunist dhe se ka luftua kundër fashistëve. Në këtë rast përgjegjësi kane edhe fshataret e fshatit Prekal, që nuk ishin në një mendje, por të përçarë pro e kundër, sepse në fund të fundit varrezat janë të fshatit e jo të priftit. Familja detyrohet me e varros në oborr të shtëpisë, gjë e cila nuk ka ndodh as me kriminelët me damkë. E ëma arkën e nusërisë e bën arkivol. Janë rrëqethëse fjalët e saj:

*Arkën teme që nuse u bana
arkivol po ta ban nana
s'po len prifti me t' çua në varr
po t'shtjen nana ktu n' oborr.*

Mbas disa kohësh kjo padrejtësi iu kthye normalitetit dhe më në fund u varros në varrezat e fshatit. Mbas çlirimit të vendit u ç varros përsëri dhe varrosët në varrezat e dëshmorëve në Shkodër dhe në fund u ç varros përsëri dhe u varros në varrezat e dëshmorëve të kombit, ku prehet edhe sot, në pavdekësinë e tij.

Çdo sistem ka të mirat e të këqijat e veta, prandaj duhen me i vlerësua me objektivitet bardh e zi siç janë.

Sistemi monist në pastë pas ndonjë të mirë ka qenë sepse ka vlerësua heroizmin e veprimtarinë e bijve të shqipes, që u flijuan për Atdheun e tyre e ndërtimin e Shqipërisë së re. Shumë i vlerësuar ka qenë edhe Tomë Kola, ju është dhënë titullin "Hero i Popullit". U ngritën për të lapidare dhe pranë tyre zhvilloheshin shumë veprimtari në kujtim të heroizmit të tij. Në një veprimtari shumë masive, që u zhvillua pranë lapidarit në Domën, rap-sodi ndër të tjera tha:....

*Të lumtë Tomë nderove vendin
se turpërove Mehmet Shpëndin
Dukagjinin as malësinë
me gjak tan shkrove lirinë*

Konviktit "Malet tona" iu dha emri "Tomë Kola", të cilin e vendosën në Khan e Thethë të Dukagjinit, për të qenë më afër shkollimit të bijve e bijave dukagjinase. Pastaj u vendos në Shkodër, në të cilin janë strehuar shumë dukagjinasi e vijuar shkollimin e tyre në shumë shkolla të arsimit bazë në qytetin e Shkodrës. Ka shumë kohë, që nuk funksionon konvikti.

Ka pas shumë emërtime institucionesh, lagjesh e rrugësh me emrin e tij, të cilat sot janë pakuar. Sot përkujtohen kriminel, vrasës të vetedeklaruar, bashkëpunëtor me pushtuesin dhe marrin shpërblime materiale pasardhësit e tyre deri edhe ata që kanë bërë burg për grabitje e vrasje, kurse Tomë Kola e shumë të tjerë si ai qëndrojnë në hije pa asnjë vlerësim. Të afërmit e tij nuk kanë pas e nuk kanë asnjë privilegj. Personalitetet më të rëndësishme të partisë - shtet të kohës i kanë ofruar vëllait të tij Mark Zefi gatishmërinë e tyre që të largohet nga fshati e të vendoset në zonat urbane për ta pas më të lehtë me i rritë fëmijët e shkolluar ata, por ai nuk ka pranuar me e lënë vendlindjen. Ai ka jetuar me djersën e ballit në kushtet e një varfërie të plotë, duke i edukuar fëmijët me vlerat më të mira të malësorit. Por Zoti e ka shpërblye ndershmerinë e tij, sepse sot bijtë e bijat e tij jetojnë shumë mirë në pavarësinë e tyre anë e kënd qarkut të Shkodrës, pa u shkëput as nga vendlindja, të cilët janë krenar për babën e Axhën e tyre, sepse ju lanë pasurinë më të madhe – fjalën e mirë.

U përpoqa, që sado pak të shkundi nga pluhuri i harrësës figurën e lavdishme e heroike të heroit të popullit Tomë Kola, birit të Dukagjinit e Shkodrës, i cili dha jetën në lulen e rinisë për një Shqipëri të lirë. Ai luftoj për idealet e larta atdhetare e patriotike, sepse nuk e dinte se ç rrugë do të merrte Shqipëria dje as sot. Shpresoj që në vitet në vijim të vlerësohet siç e meriton, të zënë më shumë vend në krijimtarinë letrare, artistike e kulturore nga krijuesit e shumë dukagjinasi. Të ketë më shumë veprimtari për të nga pushteti lokal, shoqatat e ndryshme, shkollat e të tjera.

Lavdi veprës dhe heroizmit të Tomë Koles! I përjetshëm qofte kujtimi i Tomë Koles!

**PRËLË SHYTANI,
Shkodër, maj 2024**

Kampionati Evropian i Futbollit

Ka startuar Kampionati Evropian i Futbollit ku tri herë kampionia e Evropës, Gjermania është mirëpres kampionatin evropian për herë të dytë. Shqipëria merr pjesë për herë të dytë në këtë kampionat së pari në 2016 dhe 2024. Ngjyrat kuq e zi kanë veshur qytete ku kombëtrja jonë po luan dhe kjo pjesëmarrje na bënë të ndihemi krenarë dhe besojmë në një ecuri dhe paraqitje dinjitoze të Kombëtres Shqiptare.

Për lexuesit e Gazetës Dukagjini në këtë rastë po ju sjellim pak histori nga Kampionati Evropian i Futbollit.

UEFA Kampionati Evropian i Futbollit është garimi kryesor futbollistik i kombëtareve Evropiane në futbollin e meshkujve organizuar nga UEFA. Ky garim mbahet çdo katër vite që nga viti 1960. Fillimisht ky garim u emërua si Kupa e Nacioneve Evropiane, duke ndërruar në emrin Kampionati Evropian i Futbollit në vitin 1968. Garimi llogaritet i dyti më i rëndësishmi mes kombëtareve bazuar në famën Evropiane dhe botërore pas FIFA Kampionati Botëror i Futbollit.

Përveç kësaj është edhe UEFA Kampionati i Femrave inauguruar në vitin 1984 dhe që nga viti 1997 mbahet çdo katër vite sikurse edhe Kampionati Evropian për Nën-21, kampionat ky për meshkuj që mbahet çdo dy vjet.

Para vitit 1980, vetëm katër kombëtare kualifikoheshin për në garimin final. Që nga viti 1980 tetë ekipe garonin, kurse që nga viti 1996 garimi u zgjerua përsëri në numrin nismëtarë prej 16 kombëtareve në garimin final. Ekipet garuese zgjidhen pas një serie të garimit kualifikues. Në vitin 1960 dhe 1964 zgjidheshin përmes lojërave vendas/nikoqir, kurse nga viti 1968 përmes kombinimit; garimit në grupe dhe mysafir/nikoqir ndeshjeve. Ekipi/ekipet organizues zgjedhet direkt për në garimin final.

Kampioni i fundit asnjëherë nuk ka kaluar direkt në garimin final, por ka marr pjesë në garimin kualifikues sikur dhe ekipet tjera.

Trofeu aktual i Kampionatit Evropian

Henri Delaunay Trophy që i jepet fituesit të garimit (Kampionit Evropian) është emëruar për nder të sekretarit të parë gjeneral të UEFA, Henri Delaunay, i cili e dha idenë e Kampionatit Evropian, por vdiq pesë vite para zhvillimit të garimit të parë në vitin 1960. Djali i tij Pierre Delaunay ishte përgjegjës për ndër-

timin e trofeut. Ky trofe, me të njejtat përmasa, është dhuruar që në Kampionatin Evropian të vitit 2004.

Për Kampionatin Evropian të vitit 2008 trofeu u rimodelua duke iu ndërruar përmasat, në një trofe më të madhë. Trofeu u ndërtua me përmasa 18 centimetra më i lartë dhe 2 kilogram më i rëndë duke arritur peshën totale në 8 kilogram dhe gjatësinë në 60 centimetra.

Për tu kualifikuar në garimin final

në grupin përkatës i pari dhe i dyti i grupit kualifikohen për në çerek finale.

Kampionatin Evropian e kanë fituar:

Gjermania 3 herë (1972,1980,1996)
Franca 2 herë (1984, 2000)
Bashkimi Sovjetik (1960)
Italia 2 herë (1968, 2020)
Spanja 2 herë (1964, 2008)
Çekosllovakia (1976)
Hollanda (1988)



ekipet duhet të jenë fituese ose të zënë vendet e dyta në garimin kualifikues. Ekipet ndahen në 7 grupe kualifikuese. Pas përzgjedhjes ekipet vazhdojnë në garimin final, fillimisht garimin gruporë, në vendin/vendet nikoqir/e i cili vend (ose vende) është kualifikuar direkt në garimin final përshkak se është organizues i garimit. Garimi kualifikues fillon në vjestë menjëherë pas mbarimit të Kampionatit Botëror dhe zgjat gati dy vite para garimit final.

Grupet kualifikuese përzgjidhen nga komiteti i UEFA-së duke marr parasyshe disa kriteret.

Gjstëmbëdhjet ekipet e kualifikuara për garimin final mblidhen përsëri në katër grupe të garimit final gruporë si dhe ekipi/ekipet nikoqir, grupet përzgjidhen duke përdorur metodën e tërhqjes nga aa e koisionit të UEFA-s. Ekipet e këtyre katër grupeve luaj ndeshje të formatit të ligave, secili me secilin. Pas zhvillimit të secilit ekip nga një ndeshje me secilin ekip

Danimarka (1992)
Greqia (2004)
Portugalia (2016)

Vendet mikeprite te kampionatit Evropian jane:

Tre here Franca: 1960, me 1984 e 2016
Dy here Belgjika, me 1973 3 2000
Dy here Italia, me 1968 e 1980
Nje here Austria, me 2008
Dy here Anglia, me 1996 e 2020
Dy here Gjermania, me 1988 e 2024
Nje here Hollanda, me 2000
Nje here Polonia, me 2012
Nje here Poertogalia, me 2004
Nje here Spanja, me 1964
Nje here Suedia, me 1992
Nje here Zvicra, me 2008
Nje here Ukrahina, me 2012
Nje here Jugosllavia, me 1976

Disa nga stadiumet janë përdorur edhe herën e parë, por kësaj here me ndry-

shime të mëdha në dukje. Disa do të 'debutojnë' në garat ndërkombëtare. "Olympiastadion", Berlin Kapaciteti i stadiumit: 70,00 Klubi që luan aty: Hertha Berlin "Olympiastadion" në qytetin e Berlinit, është stadiumi më i madh që do të përdoret në "EURO 2024". Në të janë luajtur çdo finale e Kupës së Gjermanisë që nga viti 1985, gjersa po ashtu edhe ndeshja tjera të mëdha në nivelin ndërkombëtar, si finalja e Ligës së Kampionëve mes Barcelonës e Juventusit më 2015.

Ky stadium po ashtu ishte mikpritës edhe i finales së Kupës së Botës më 2006. Pra, nuk është befasi që finalja e madhe e "EURO 2024" do të luhet pikërisht në këtë stadium, me ndeshjen që zhvillohet më 14 korrik.

Histori e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Kampionatin Evropian nis më 29 Qershor 1963 në Kopenhagën për eliminatorët e kampionatit Evropian 1964 I cili u zhvillua në Spanjë dhe u fitua nga Spanja. Shqipëria u kualifikua në 16-she pasi ndeshjet e me Greqin u fitua ne tavolin pasi Greqia nuk pranoi te lunte dhe ne ate kohe ishte "rregulli I luftes". Ndeshjen tjetër ne Kopenhage me Danimarkën ne e humbëm me rrezulltatn 4-0 ndersa ndeshja e dytë u luajt në Tiranë ku fituam 1-0 me gol të Panajot Panos në minutën e 3'. Kështu kombëtarja jonë

kisht tri fitore dhe një humbje (dy fitore me Greqinë dhe nje fitore me Danimarkën) Kombëtrja jonë u drejtu nga I madhi Loro Boriçi dhe në gjirin e saj kishtë edhe djalin Dukagjin Lin Shllaku. Kjo ëndërr e madhe e futbollit shqiptarë do ndërpritej misorish si shkak I vetëizolimit që bëri vendi ynë.

Me ecurin e deritanishme të Kombëtres tonë në këto finale na bejnë të ndihemi krenarë për djemtë që po japin shpirtin në fushën e lojës dhe besojmë se tashmë rruga drejt fitoreve të mëdha ka filluar. Besojmë se flamuri ynë do valvitet duke I shoqruar me flladin e tij djemt tanë në fitore dhe rekorde te reja. Tifozeria Shqipatre po shpalos ndjen atdhetrie dhe qytetarie Ilirjane dhe kjo është fitore që Evropa tashmë e ka pranuar dhe po mbetet gjatë në kujtesen e të gjithvë. Ju urojmë fitore Kombëtres dhe rekorde të tjera në ditët në vazhdim.

ROZA PJETRI

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj

Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin
REDAKSIA